



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 16 regjistër (JR)
Datë 02.06.2020

Nr. 23 i vendimit
Datë 28.06.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.06.2022, ditën e martë, në orën 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Astrit Shema, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 239, datë 21.2.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 239, datë 21.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Astrit Shema (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në kohën e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Komisioni, në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e neneve 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e dërguara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”).
 - 2.1. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë të subjektit të rivlerësimit¹, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar², duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Bazuar në nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-

¹ Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së, brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

² Raporti i ILDKPKI-së, administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 13.07.2018.

ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 239, datë 21.2.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 239, datë 21.2.2020, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Astrit Shema, bazuar në konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si më poshtë.

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë deklaram të rremë, duke fshehur burimin e vërtetë të krijimit të këtyre pasurive, duke bërë deklaram jo të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.

4.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të pasurive të përmendura në këtë vendim, sipas paragrafit 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

4.3 Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim dhe përdorim të tij, dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 239, datë 21.2.2020, të Komisionit, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore³, subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), duke pretenduar se vendimi është i pabazuar në ligj, ka qenë i paragjykuar dhe paracaktuar, është rezultat i cenimit dhe shkeljes së normave dhe rregullave procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike për vlerësimin e kriterit të pasurisë.
6. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, paraqiti disa akte shkresore⁴, tri prej të cilave rezultojnë të administruara në fashikujt e Komisionit, ndërsa për dy vendime gjyqësore të dhëna prej tij si gjyqtar i vetëm, të paadministruar në fashikujt e Komisionit, subjekti nuk ka paraqitur kërkesë për marrjen e tyre në cilësinë e provave të reja. Nga përmbajtja e ankimit, rezulton që dy vendimet gjyqësore janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të mbështetur pretendimet për paragjykim dhe paramendim nga ana e Komisionit në dhënien e vendimit, për shkak të qëndrimeve të mbajtura prej tij në dhënien e tyre. Bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve

³ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar ankimin në Komision me nr. {***} prot., datë 18.05.2020.

⁴ Faqet 5 dhe 6 të deklaratës vetting; deklarata noteriale e shtetasit F. B. me nr. {***} rep./nr. {***} kol., datë 24.01.2017; deklarata noteriale e shtetasit K. B. me nr. {***} rep./nr. {***} kol., datë 24.01.2017; vendimi nr. {***}, datë 7.11.2013, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (gjyqtar Astrit Shema); vendimi nr. {***}, datë 27.06.2019, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (gjyqtar Astrit Shema).

administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

(i) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke çelur hetimin gjyqësor edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit.

(ii) Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj subjektit të rivlerësimit Astrit Shema, gjyqtar/kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

(iii) Përfundimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale dhe ndryshimin e vendimit nr. 239, datë 21.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Astrit Shema, gjyqtar/kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

7. *Shkaqet e ankimit për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon për cenim të procesit të rregullt ligjor dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të tij, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

7.1. Vendimi është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, pasi nuk është kryer hetim administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit.

7.2. Konkluzioni i Komisionit është nxjerrë në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7.3. Vendimi i Komisionit është në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, për shkak se gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, në shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike, si dhe në shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, për shkak se nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit.

7.4. Komisioni nuk ka zbatuar parashikimet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dispozitë ligjore e cila, sipas tij, kërkon të plotësohet edhe pamjaftueshmëria në kontrollin e figurës, ndërkohë që nga ana e Komisionit, kriteri i kontrollit të figurës nuk është marrë në analizë dhe nuk është vlerësuar. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se pasaktësitë në deklaram, të palidhura me indicie për korrupsion apo veprimtari të tjera të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit, për vetë renditjen në mënyrë kumulative të kriterëve në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

8. *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspekt të konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.*

8.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar dhe alogjik vendimin e Komisionit pasi, sipas tij, “nxjerr një diferencë të pambuluar të pasurisë, pothuajse sa vlera e pasurisë edhe pse vlera e të ardhurave të ligjshme të z. Shema është vetëm 29% e të ardhurave të tij të ligjshme”. Sipas subjektit, në deklaramin e pasurisë në deklaramin e rivlerësimit *vetting*, nuk konstatohet asnjë pasaktësi, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, lexuar në harmoni me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë dhe pasuritë justifikohen me burime financiare të ligjshme.

8.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit *se subjekti i rivlerësimit dhe dy prej personave të tjerë të lidhur, F. B. dhe Sh. M., nuk paraqitën dokumentacion ligjor justifikues për burimin e krijimit të truallit me sipërfaqe 500 m², në bashkëpronësi, në Tiranë, duke pretenduar se: (i) të ardhurat e familjes Shema kanë qenë më se të mjaftueshme për të investuar në blerjen e truallit në vitin 2002; (ii) shtetasit F. B. dhe Sh. M. nuk janë persona të tjerë të lidhur me subjektin, pasi me ta nuk ka pasur asnjë lidhje interesi apo marrëdhënie biznesi, secili prej këtyre shtetasve ka paguar pjesën e vet takuese, dhe se këta shtetas nuk i kanë dhuruar asgjë subjektit.*

8.3. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme 4 kate + 1 kat, në bashkëpronësi (Astrit Shema, K. B., F. B., Sh. M.), në qytetin e Tiranës*

8.3.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit *se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe është përpjekur të fshehë fakte të rëndësishme për pasuritë në pronësi të tij, si dhe ka bërë deklaram të rremë në lidhje me datën e fillimit të punimeve të godinës, duke pretenduar se: (i) ka deklaruar me përgjegjësi pagesat dhe investimin për pjesën e tij takuese, sipas vlerave të deklaruara me vërtetësi në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, të cilat kanë vlerë provuese në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (ii) investimi fillestar për ndërtimin e objektit është kryer në vitin 2005 dhe nuk ka lidhje me fillimin e punimeve.*

8.3.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit *se ndërtimi i godinës 4 kate +1 kat ka përfunduar në vitin 2006, duke pretenduar se për efekt të legalizimit, objekti konsiderohet i përfunduar edhe kur ka mbaruar vetëm karabinaja, por për ta bërë apartamentin të banueshëm, investimi prej tij ka vijuar për punimet pasuese deri në vitin 2008.*

8.3.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit *se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën e investimeve të kryera në godinë, nuk ka deklaruar saktë fakte të rëndësishme për këto prona të tij, ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 3.784.113 lekë, për të investuar në pjesën e tij takuese, duke pretenduar se: (i) investimi për ndërtimin e godinës është kryer në vitet 2005-2008, dhe jo në vitet 2003-2006; (ii) në deklaratën e rivlerësimit *veting*, deklarimi është i saktë, në përputhje me deklaramet në vite, përfshirja e vlerës së truallit, edhe në vlerën e ndërtesës, është theksuar në deklaratë duke përdorur lidhësen “dhe”, mënyrë e qartë deklarimi sipas qasjes dhe vlerësimit të tij se trualli dhe ndërtesa janë trupëzuar në një pasuri të vetme; (iii) vlera e investimit nuk është llogaritur saktë nga Komisioni, pasi nuk është përlllogaritur saktë kostoja e punimeve në pjesën takuese të katit të parë (karabina), si dhe kostot e ndërtimit të kryer në mënyrë informale; (iv) ka deklaruar saktë pjesën takuese dhe investimin përkatës në godinën në bashkëpronësi, shtetasit K. B. dhe F. B. nuk kanë deklaruar se kanë dhuruar pjesën takuese në katin përdhe, por kanë deklaruar se në pjesët takuese në këtë kat, nuk është investuar prej tyre, por prej subjektit; (v) qëllimi i marrjes së kredisë prej 30.000 eurosh, në Alpha Bank, në vitin 2006, si dhe shpenzimi i saj, ka qenë mbulimi i shpenzimeve të ndërtimit.*

8.4. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit *se ka mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2015, në shumën 321.173 lekë, duke pretenduar se blerja e pajisjes për sistem ngrohje/ftohje është përlllogaritur dy herë, në zërin “shpenzim për arredim” dhe si shpenzim më vete.*

8.5. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë, referuar germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë automjet, tip “Mercedes Benz 210”, {***}, me targa {***}, duke pretenduar se mosdeklarimi në deklaratën e interesave private periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2010, i huas së marrë përkohësisht dhe të shlyer plotësisht në fund të vitit me të ardhurat e subjektit, mund ta bëjë deklarin e paplotë, por jo të rremë.

8.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit *se, për sa nuk janë paguar detyrimet tatimore për vlerën e fitimit, të realizuar nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2007 [...], [diferenca prej 500 eurosh mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes], vlera e fitimit do të vlerësohet si e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016*, duke pretenduar se fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nga individët, jo në kuadër të një veprimtarie tregtare, nuk rezulton të jetë parashikuar si e ardhur e tatueshme në kuadrin ligjor në fuqi, në Republikën e Shqipërisë.

8.7. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit *se ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me apartamentin në përdorim në qytetin e Vlorës, në mënyrë të pandërprerë, që nga blerja dhe pa kundërshtim, duke mos paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e ligjshme në shumën 30.600 euro të personit tjetër të lidhur*, duke pretenduar se nuk mund të aludohet për asnjë gjurmë apo indicie për fshehje të mundshme të pasurisë, dhe nuk është i bazuar në ligj deklarimi i shtetasi A. O., person tjetër i lidhur vetëm për shkak të përdorimit të banesës së tij nga subjekti i rivlerësimit.

8.8. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit *se në deklaratën “vetting”, duhet të kishte deklaruar pasurinë e pritshme, trull me sip. 4.000 m² në bashkëpronësi, në {***}, Përmet, si një e drejtë reale e fituar prej tij nga dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht kohës kur e zotëron këtë pronë*, duke pretenduar se në momentin e deklarimit në deklaratën *vetting*, nuk ekzistonte asnjë mundësi që pronë të njëjtit apo kompensohej.

8.9. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit *se nuk ka vepruar në përputhje me vlerat dhe parimet themelore të sjelljes së një magjistrati, jashtë funksionit të tij, gjë që e bën të cenueshëm në etikën e magjistratit*, duke pretenduar se nxjerrja e këtij konkluzioni nga Komisioni, për sa nuk është hetuar kriteri i figurës, cenon procesin e rregullt ligjor, se ndërtimi informal është kryer në truallin e bashkëpronarëve jo në pronë publike, jo me vendimmarrje personale, por edhe të tre bashkëpronarëve të tjerë.

8.10. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionet e Komisionit për analizën financiare për vitet 2003-2016, duke pretenduar se: (i) kredia e marrë në Alpha Bank, është shpenzuar për ndërtimin e godinës dhe jo për rikonstruksionin e saj; (ii) shpenzimet për ndërtimin e godinës janë kryer prej tij në periudhën 2005-2008; (iii) të ardhurat nga qiraja, në vlerën 108.000 lekë, janë të ligjshme dhe duhet të përfshihen në analizën financiare të vitit 2015; (iv) shpenzimi për blerjen e pajisjes ngrohje/ftohje duhet të përllogaritet vetëm një herë në analizën financiare të vitit 2015; (v) shpenzimet e interesit të kredisë në Alpha Bank, në shumën 103.961 lekë, janë përfshirë në vlerën e huas së marrë nga z. G. dhe nuk duhen llogaritur si zë më vete; (vi) shpenzimet për automjete, për të dhe për bashkëshorten, janë të përfshira brenda zërit statistikor “Shpenzime jetese”, të llogaritura nga Komisioni; (vii) nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, me targa

{***}, humbja është 50.000 lekë dhe jo 210.000 lekë, si e llogarit Komisioni; (viii) shpenzimet për pushime brenda vendit janë të përfshira në zërin “Shpenzime jetese”.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), fillimisht mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi vendimin e Komisionit nr. 239, datë 21.2.2020. Në këndvështrim të pretendimeve të parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe konstatimin në mënyrë të plotë të gjendjes faktike, trupi gjykues nuk evidentoi shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, të cilat në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, do të sillnin nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike për korrigjimin e tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

12. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është i paragykuar, i paracaktuar, i pabazuar në Kushtetutë apo në ligjin nr. 84/2016, është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, pasi nuk është kryer hetim administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson si vijon.

12.1. Lidhur me pretendimin e subjektit për vendim paragykuar dhe të paracaktuar, të marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, pa u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë apo në ligjin nr. 84/2016, pasi procesi i rivlerësimit është bazuar vetëm

në kriterin e pasurisë, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit⁵, trupi gjykues vlerëson se parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, lidhur ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht fillon dhe finalizohet me shqyrtimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të tejkaluar pretendimin për paragjykim dhe paracaktim të vendimmarrjes nga ana e Komisionit, për sa ky pretendim lidhet me dhënien e masës disiplinore, bazuar në kryerjen e rivlerësimit të bazuar vetëm në një kriter. Në analizimin e shkaqeve të ankimit në vijim, do të analizohen edhe pretendimet konkrete të subjektit për konkluzione të Komisionit, të arritura, sipas tij, mbi bazë paragjykimi dhe paracaktimi të vendimmarrjes.

12.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se plotësimi i hetimit administrativ edhe me kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale dhe të figurës, është i domosdoshëm për njohjen në tërësi të subjektit të rivlerësimit dhe për vendimmarrje të pacenueshme, ndërsa përfundimi i hetimit administrativ bazuar vetëm në një kriter, cenon standardet e procesit të rregullt ligjor, përbën paragjykim të thellë, vë në dyshim paanësinë e Komisionit, trupi gjykues konstaton *së pari*, se pavarësisht vendimit për të mbyllur hetimin administrativ mbështetur vetëm mbi një kriter, në funksion të zhvillimit të një procesi të drejtë ligjor, në respektim të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar e mbrojtur, Komisioni ka njoftuar subjektin se kjo vendimmarrje mund të revokohet dhe të vazhdojë procedurën hetimore administrative edhe për kriteret e tjera, në rast se me shpjegimet dhe provat e paraqitura në seancë dëgjimore, subjekti do të arrinte të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ kryesisht; dhe *së dyti*, se për sa Komisioni, në vlerësim të shkeljeve të konstatuara në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, ka arritur në përfundimin se subjekti nuk e kalon testin e besueshmërisë për këtë kriter, në funksion të efikasitetit të procesit, hetimi për dy kriteret e tjera do të mbetet irelevant, pasi çfarëdolloj konkluzioni për to nuk do të afektonte vlerësimin për kriterin e pasurisë, të vlerësuar në mënyrë autonome dhe të konsideruar të mjaftueshëm për arritjen e marrjes së një vendimi, bazuar në parashikimin e pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Një situatë e tillë procedurale, në përputhje të plotë me parashikimet kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e procesit të rivlerësimit, tejkalon pretendimet e subjektit për paragjykim apo paracaktim të vendimit, si dhe për mungesë të arsytimit në vendim lidhur me mospërfshirjen e komponentëve të vlerësimit të figurës dhe të vlerësimit profesional.

12.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka interpretuar drejt nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, i cili duhet të lidhet njëkohësisht si me kriterin e pasurisë, ashtu edhe me kriterin e figurës, trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁶ në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vlerësimi për secilin kriter rivlerësimi (atë të pasurisë dhe pastërtisë së figurës) është i pavarur dhe mund të çojë po në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit të rivlerësimit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm.

⁵ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 3/2018, datë 17.07.2018; nr. 1/2019 (JR), datë 31.01.2019; nr. 3/2019 (JR), datë 07.02.2019; nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; nr. 12/2018 (JR), datë 29.05.2019; nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; nr. 28/2019 (JR), datë 24.10.2019; nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021; nr. 9, datë 11.04.2022.

⁶ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 9 (JR), datë 24.10.2018; nr. 7 (JR), datë 05.04.2019; nr. 28 (JR), datë 30.10.2019; nr. 34 (JR), datë 15.11.2021 etj.

12.4. Subjekti pretendon se edhe nëse kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk do të ishin kumulative, vlerësimi i Komisionit për shkarkimin nga detyra nuk do të ishte i bazuar, pasi sjellja e subjektit në kuadër të deklaramit të pamjaftueshëm, duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie si shkeljet e renditura në pikat e tjera të nenit 61, dhe se mungesa e burimeve financiare për të justifikuar pasuritë (*parashikuar në germën “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit*) mund të përbëjë deklaramit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë, deklaramin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, trupi gjykues sjell në vëmendje se koncepti i deklaramit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet në raport me konstatimet e procedurës së vlerësimit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Parashikimet e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si të pavarura, vlerësimi i të cilave në kuadër të prodhimit të pasojave sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, u nënshtrohet parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit.

- 13.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit është nxjerrë në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës; nenit 4, pikat 5 dhe 6; nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues analizon si vijon.

13.1. Për t’i dhënë përgjigje pretendimit të subjektit për detyrimin e Komisionit për të kaluar barrën e provës për çdo gjetje që, sipas vlerësimit të tij, prodhon si sanksion marrjen e masës disiplinore, në kuadër të garantimit të së drejtës për t’u dëgjuar në mënyrë efektive, trupi gjykues shqyrtoi raportin e Komisionit për rezultatet e hetimit kryesisht dhe pretendimet që subjekti ka paraqitur rreth tij. Nga përmbajtja e raportit, konstatohet se Komisioni ka pasqyruar në mënyrë të plotë të gjitha faktet e dala nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ kryesisht, si edhe nga shpjegimet e subjektit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, për gjetjet e konstatuara, të pasqyruara qartë në raport, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht. Nga prapësimet e paraqitura nga subjekti, dëshmohet dijenia e plotë e tij për gjetjet e hetimit administrativ kryesisht, provat dhe faktet në të cilat Komisioni i ka bazuar ato, dhe barrën e provës kaluar atij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit paraprak. Subjekti i rivlerësimit, në përmbushje të barrës së provës, ka paraqitur 44 akte të konsideruara prej tij si prova të reja. Pretendimi i vetëm i parashtruar nga subjekti në prapësime për moskalim të barrës së provës, ka të bëjë me gjetjet për vlerat e padeklaruara prej tij në llogarinë e djalit dhe të bashkëshortes, për të cilat Komisioni, në raportin e rezultateve të hetimit kryesisht, i ka kërkuar të japë shpjegime, pa e ngarkuar me përgjegjësi. Kuadri kushtetues dhe ligjor i procesit të rivlerësimit përcakton detyrimin e organeve të rivlerësimit, në këtë rast Komisionit, t’i kalojnë barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën, çdo rast kur nga hetimi, kanë rezultuar situata të cilat e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi. Në kushtet kur Komisioni, ndonëse e ka evidentuar këtë situatë si në shkelje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr. 84/2016, nuk e ka renditur atë të shkaqet që kanë shërbyer për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pretendimi i subjektit se është cenuar në këto kushte procesi i rregullt, vlerësohet prej Kolegjit si pa ndikim në zgjidhjen e çështjes, për pasojë shkak i ankimit konsiderohet i pambështetur.

13.2. Lidhur me pretendimin e subjektit për shkelje të parimit të kontradiktoritetit, pasi, sipas tij, Komisioni, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 49/9 të ligjit nr. 84/2016, nenit 25 dhe 34 të ligjit nr. 49/2012, nenit 183 të Kodit të Procedurës Civile⁷, nuk ka respektuar procedurën e marrjes së provave dhe, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48 të KPrA, nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura prej tij, ka vlerësuar subjektivisht vlerën e tyre sepse ka paracaktuar e paragjykuar rezultatet e hetimit, për shkak të qëndrimeve objektive e ligjore të mbajtura nga subjekti gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, duke e kthyer seancën dëgjimore më datë 19.02.2020, në një seancë tërësisht formale, trupi gjykues analizon si vijon.

13.2.1. Në vendimin e Komisionit, janë pasqyruar të gjitha provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me prapësimet për rezultatet e hetimit kryesisht⁸, është kryer analizimi dhe vlerësimi i tyre në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket dobishmërisë dhe provueshmërisë së tyre në raport me provat e tjera të administruara gjatë hetimit, konkretisht: (i) me vërtetimin e lëshuar nga Raiffeisen Bank, Komisioni ka vlerësuar të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Përmet për vitin 2015; (ii) me provat e paraqitura nga subjekti,

⁷ Kodi i Procedurës Civile, në nenin 183, parashikon se: “Për kërkesat e parashtruara nga palët sipas neneve 180 dhe 182 të këtij Kodi, gjykata shprehet me vendim. Në raste të veçanta, që paraqesin vështirësi gjykimi, ajo mund ta shtyjë deklarimin e vendimit deri në tri ditë. Gjykata, me vendim, lejon marrjen e provave dhe kur është rasti edhe mënyrën e marrjes së tyre. Refuzimi i marrjes së provës së kërkuar duhet të arsyetohet nga gjykata, pa e paragjykuar çështjen”.

⁸ Subjekti ka dorëzuar 44 dokumente, për të cilat ka kërkuar për t'u marrë si provë nga Komisioni: 1. fotokopje e noterizuar e librezës së punës së z. Astrit Shema; 2. fotokopje e noterizuar e librezës së punës së bashkëshortes, znj. M. Sh. ; 3. kërkesë drejtuar Arkivës së Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore, së bashku me printimin; 4. listëpagesa për shpërblimet 2004-2005, për znj. M. Sh. ; 5. vërtetim nr. {***} 1.11.2019 për depozitën bankare në Bankën e Kursimeve në emër të z. Astrit Shema; 6. vërtetim i shkollës 9-vjeçare “{***}” nr. {***} 6.2.2020 për largimin e nxënëses F. Sh.; 7. vërtetim i gjimnazit “{***}” nr. {***} prot./6.2.2020, për largimin e nxënësit A. Sh.; 8. kontratë shitje nr. {***}/118, datë 23.02.1996, shitës K. B.; 9. kontratë shitblerjeje nr. {***}, datë 7.02.1998, shitës K. B.; 10. kontratë shitblerjeje nr. {***}, datë 23.12.1998, shitës K. B.; 11. kontratë shitblerjeje nr. {***}, datë 23.10.2001, shitës K. B.; 12. kontratë shitblerjeje nr. {***}, datë 5.02.2002, shitës K. dhe V. B.; 13. kontratë qiraje nr. {***}, datë 22.01.2003, qiradhënëse V. B.; 14. kontratë qiraje nr. {***}, datë 21.04.2005, qiradhënëse K. B.; 15. vërtetim ZVRPP Përmet, nr. {***} prot./28.02.2006, në emër të K. dhe V. B.; 16. Libri i pronësisë {***}, Përmet; 17. kontratë punësimi dhe trajnimi lidhur nga z. A. O., datë 10.07.1991, Itali; 18. dokumente italiane të përkthyer në shqip, lëshuar nga shoqëria “{***}” për pagesat për z. A. O. i, 10.07.1991 - 14.01.1992; 19. librezë pune e z. A. O.; 20. librezë depozitimi në emër të z. A. O., Sodrino; 21. përmbledhje llogarie e shoqërisë “{***}”; 22. vërtetim i artizanëve të provincës Sorino; 23. kopje e pasaportës së z. A. O. me vula hyrje-dalje nga shteti grek, si dhe viza greke; 24. shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 13.09.1999; 25. shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 04.09.2000; 26. shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 28.06.2001; 27. shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 31.07.2001; 28. shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 8.07.2003; 29. shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 6.07.2004; 30. Shënim likuidues i tatimit, lëshuar nga Ministria e Financave të Greqisë, datë 22.07.2005; 31. librezë kursimi në emër të bashkëshortes së z. A. O.; 32. vërtetim i Shoqatës së Epirit të Veriut, 17.05.1995; 33. vërtetim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore të Greqisë; 34. kontratë {***}, datë 29.10.2003, shitës A. O.; 35. dokumentacion në gjuhën greke për të ardhurat e nënës së z. A. O.; 36. dokumentacion në gjuhën greke, përkthyer dhe noteruar, për të ardhurat e z. Sh. M. dhe të bashkëshortes, 2006; 37. dokumentacion në gjuhën greke, përkthyer dhe noteruar, për të ardhurat e z. Sh. M. dhe të bashkëshortes, 2007; 38. dokumentacion në gjuhën greke, përkthyer dhe noteruar, për të ardhurat e z. Sh. M. dhe të bashkëshortes, 2008; 39. dokumentacion në gjuhën greke, përkthyer dhe noteruar, për të ardhurat e z. Sh. M. dhe të bashkëshortes, 2010; 40. dokumentacion në gjuhën greke, përkthyer dhe noteruar, për të ardhurat e z. Sh. M. dhe të bashkëshortes, 2011; 41. dokumentacion në gjuhën greke, përkthyer dhe noteruar, për të ardhurat e z. Sh. M. dhe të bashkëshortes, 2012; 42. deklaratë noteriale e z. K. B. nr. {***}, datë 13.02.2020, për huadhënien e shumës 350.000 lekë; 43. akti i ekspertimit tekniko-inxhinierik; 44. akti i ekspertimit kontabël.

Komisioni ka arritur në konkluzionin se shtetasi K. B. ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë truallin dhe për të kryer investimin në ndërtimin e pjesës takuese të objektit 4 kate + 1 kat; (iii) me provat e paraqitura nga subjekti për të ardhurat e shtetasit A. O., Komisioni ka arritur në konkluzionin se ky shtetas ka pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huas 10.000 euro; (iv) për shkak të pamjaftueshmërisë së dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, Komisioni ka arritur në konkluzionin se shtetasi Sh. M. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për të investuar në ndërtimin e pjesës takuese të objektit; (v) për aktekspertimin tekniko-inxhinierik, të porositur nga subjekti në përmbushje të barrës së provës, Komisioni ka vlerësuar se nuk qëndron, për sa të dhënat e këtij akti nuk vinin në përputhje me dokumentet e praktikës së legalizimit, siguruar nga ALUIZNI: (vi) për aktekspertimin kontabël, të porositur nga subjekti në përmbushje të barrës së provës, dhe pretendimet për përlogaritjen e shpenzimeve të jetesës, sipas metodologjisë së përdorur nga eksperti kontabël, Komisioni ka argumentuar për arsyet e mospërdorimit të referencave të pretenduara dhe për bazueshmërinë e vlerësimit të tij në të dhënat zyrtare të kohës. Për sa më lart, trupi gjykues konstaton se në përputhje me parashikimet nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 57, pika 4, germa b e ligjit nr. 84/2016, Komisioni në vendim ka identifikuar të gjitha provat e paraqitura nga subjekti, provat e marra për shqyrtim dhe shkaqet për të cilat ato janë vlerësuar kur janë gjendur në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, si dhe provat e refuzuara dhe shkaqet e refuzimit të tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për shkelje të parimit të kontradiktoritetit.

13.2.2. Lidhur me pretendimet e subjektit për subjektivizëm në vlerësimin e provave për shkak të paracaktimit e paragjyqimit të rezultateve të hetimit për qëndrimet objektive e ligjore të mbajtura nga subjekti si gjyqtar, duke e kthyer seancën dëgjimore më datë 19.02.2020, në një seancë tërësisht formale, trupi gjykues, referuar akteve të administruara në fashikuj, konstaton *së pari*, se Komisioni, duke pranuar kërkesat e subjektit për kohë shtesë për paraqitjen e provave, i ka krijuar mundësitë subjektit për mbrojtje efektive. Konkretisht, (i) më datë 30.1.2019, përmes postës elektronike, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe për të paraqitur prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 10.2.2020; (ii) më datë 6.2.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, kërkoi kohë shtesë për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave që do të administronte jashtë shtetit shqiptar. Komisioni i la afat për paraqitjen e tyre deri në datën 14.2.2020; (iii) në datën 9.2.2020, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike, paraqiti një pjesë të provave të reja, në përgjigje të barrës së provës dhe në datën 14.2.2020, paraqiti fizikisht shpjegimet së bashku me pjesën tjetër të provave të reja; (iv) për shtyrjen e seancës dëgjimore [*seanca dëgjimore e njoftuar për në datë 19.02.2020, ora 10:00, në përgjigje të kërkesës së subjektit, u shty në datë 19.02.2020, ora 10:00*]. *Së dyti*, nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton që nga ana e relatores, janë referuar hollësisht rezultatet e hetimit administrativ, duke vënë në dukje çështjet që, nga pikëpamja procedurale, janë çmuar të nevojshme e të dobishme për gjykimin e çështjes, për përfundimet për të cilat Komisioni i kishte kaluar subjektit barrën e provës, si dhe për provat apo shpjegimet e subjektit në përmbushje të saj. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar, pa u kufizuar nga trupi gjykues i Komisionit, pretendimet e tij sa u përket gjetjeve të hetimit, si dhe çdo shpjegim tjetër që ka çmuar të nevojshëm, dhe nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore, të ketë kërkuar marrjen e provave të tjera. *Së treti*, koha fizike në dispozicion të subjektit për paraqitjen e provave, e shtuar në plotësim të kërkesës së tij, koha fizike në dispozicion të Komisionit pas administrimit të provave

për analizimin e tyre⁹, procesverbali i seancës dëgjimore i cili dëshmon se nga ana e subjektit, janë shpjeguar dhe shprehur argumentet për të gjitha momentet që ai i ka konsideruar të nevojshme për mbrojtjen e tij, në të kundërt me sa pretendon subjekti, tregojnë se Komisioni ka kryer një proces analitik dhe vlerësues lidhur me vlerën provuese të akteve të paraqitura prej tij dhe se seanca dëgjimore ka përmbushur efektivisht qëllimin e dhënies së mundësisë subjektit për t'u dëgjuar dhe mbrojtur. Fakti që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me sa pretenduar nga subjekti në shpjegimet e tij, apo në lidhje me vlerën provuese të aktekspertimit inxhinierik dhe financiar të paraqitur prej tij, për shkak se këto akte nuk kanë rezultuar në pajtueshmëri me dokumentet nga burime të njohura, nuk përbën shkak për të pretenduar për subjektivizëm në vlerësimin e provave, por është ushtrim prej Komisionit, i kompetencave dhe attributeve të tij analizuese e vlerësuese, të njohura nga ligji nr. 84/2016, në funksion të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Për të gjitha sa dëshmuar nga aktet në fashikuj, trupi gjykues vlerëson se subjektit i është garantuar e drejta për të paraqitur prova, të cilat janë vlerësuar në mënyrë objektive, në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

13.2.3. Lidhur me pretendimin e subjektit për njohje me rezultatin përfundimtar të hetimit përmes dërgimit të një raporti të ri nga ana e Komisionit, ku të analizohen provat e pranuar apo të rrëzuara, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimi përkatës, trupi gjykues e vlerëson në tejkallim të dispozitave procedurale dhe materiale të ligjit nr. 84/2016, por edhe të pabazuar në parashikimin e nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative¹⁰, dispozitë e referuar nga subjekti për të mbështetur këtë pretendim. Qëndrimi i Komisionit, pas kalimit të barrës së provës, është ai që deklarohet si tillë në vendimin që përmbyll procedurën administrative ndaj të cilit, subjekti i rivlerësimit ka të drejtën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

13.2.4. Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk ka asnjë shpjegim për aktin/provën, mbi bazën e të cilit janë nxjerrë rezultatet financiare apo tekniko-inxhinierike dhe nuk identifikohet personi që i ka hartuar ato, duke pamundësuar qartësinë për njohuritë e tij, trupi gjykues analizon se:

13.2.4.1. Për sa i përket pretendimit se *nuk kuptohet se cili ishte eksperti me njohuri të posaçme që mori dhe analizoi pamjet me “google earth” gjatë hetimit administrativ (për sa anëtarët e KPK-së janë juristë dhe këshilltarët e tyre juristë ose ekonomistë)*, konstatohet se subjekti, gjatë hetimit administrativ, është bërë me dije se Komisioni ka përdorur pamjet “google earth”, me qëllim përcaktimin e kohës së fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit në ndërtimin informal në

⁹ Pas paraqitjes nga ana e subjektit, më datë 14.02.2020, të pretendimeve për rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe të provave në përmbushje të barrës së provës, me vendimin e datës 17.2.2020, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në datën 19.2.2020, ora 10:00.

¹⁰ Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 87, parashikon se: “Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar”, parashikon se “Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. 2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm. 3. Afati i parashikuar sipas shkronjës “dh”, të pikës 2, të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi”.

bashkëpronësi të tij. Gjetjet, së bashku me pamjet nga platoforma “google earth”, i janë përcjellë subjektit së bashku me rezultatet e hetimit administrativ. Në prapësimet e tij, subjekti nuk ka paraqitur asnjë pretendim lidhur me mënyrën e leximit/interpretimit të pamjeve nga “google earth” prej Komisionit, për periudhën e fillimit të punimeve, duke u shprehur: *sikundër është konstatuar edhe nga ju nëpërmjet “ortophoto” në “google”, ndërtimi ka filluar në vitin 2003[...]*, ndërsa ka kundërshtuar periudhën e përcaktuar nga Komisioni lidhur me përfundimin e ndërtimit, bazuar në dokumentacionin e praktikës së ALUIZNI-t. Të dhënat e përfuara nga leximi/interpretimi i imazheve kanë plotësuar faktet e rezultuara nga dokumentacioni i praktikës së legalizimit të ndërtimit. Referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 588, datë 10.9.2014, një nga format e përcaktuara për verifikimin e ndërtimeve informale janë edhe imazhet satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm¹¹, përdorimi i të cilave, në fusha të ndryshme, konsiderohet ekuivalent me përdorimin e një harte, leximi i së cilës lidhet jo domosdoshmërisht me aftësi të caktuara. Për më tepër, objektiviteti në vlerësimin e situatës faktike nga Komisioni, bazuar edhe në leximin e “ortophoto”, konstatohet pasi: (i) periudha e fillimit të punimeve, përcaktuar sipas leximit të këtyre pamjeve, e cila rezulton e ndryshme nga ajo në praktikën e ALUIZNI-t, pranohet nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) periudha e përfundimit të punimeve, sipas leximit të këtyre pamjeve në vitin 2006, vjen në pajtueshmëri të dukshme me fotot e paraqitura nga subjekti me vetëdeklarimin e datës 17.03.2005, të administruara në praktikën e ALUIZNI-t. Në këto foto, në pamje ballore të objektit në të katër anët e tij, situacioni i ndërtimit shquhet qartë, pa lënë vend për pretendime, sikundër akti tekniko-inxhinierik tenton të interpretojë lidhur me pamjet satelitore, për të cilat shprehet se krijojnë mundësi të kufizuara për të kuptuar gjendjen e ndërtimit. Trupi gjykues, pretendimin e subjektit lidhur me leximin e pamjeve nga “google earth”, e vlerëson të pabazuar, dhe si përpjekje për të mbështetur qëndrimin e tij për përfundimin e punimeve të ndërtimit, 3 vjet më vonë se periudha e rezultuar e provuar nga praktika e legalizimit.

13.2.4.2. Lidhur me pretendimet e subjektit se *nuk identifikohet personi që ka hartuar analizën financiare, i cili nuk mban asnjë përgjegjësi ligjore, nuk dihet roli i tij përgjatë procedimit*, trupi gjykues sjell në vëmendje se pranë Komisionit funksionin Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përmbush detyrat dhe ushtron përgjegjësinë sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të rivlerësimit. Referuar parashikimeve të nenit 22 të ligjit nr. 84/2016, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin e rivlerësimit kalimtar, pa qenë e parashikuar në ligj detyrimi për identifikimin e personit konkret që ruan këtë rol në një çështje të caktuar. Analizat financiare të kryera nga kjo strukturë, i nënshtrohen debatit nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit¹² dhe, në përfundim, lidhur me to, vendos trupi gjykues i Komisionit, i ngarkuar me short për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Analiza financiare e kryer nga Komisioni, është mbështetur në të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacionin

¹¹ Në pikën 3, shkronjat “a” dhe “b” të VKM-së nr. 588, datë 10.9.2014, përcaktohet se “Verifikimi i ndërtimeve informale, brenda periudhave kohore të përcaktuara në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhet nëpërmjet të paktën njëres prej formave të mëposhtme: a) Përdorimit të produktit të fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, për periudhën kohore që ai mbulon. b) Imazheve satelitore ose ajrore të përdorimit të përgjithshëm, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga subjektet disponuese [...]”.

¹² Në datën 30.01.2020, Komisioni përmes e-mail-it, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për mbylljen e hetimit kryesisht, të drejtat e tij në këtë fazë të procesit, duke dërguar bashkëlidhur rezultatet e hetimit kryesisht, dhe 4 anekse, ku aneksi 4 është analiza financiare dhe aneksi 5 metodologjia e kryerjes së analizës financiare.

financiar pjesë e dosjes përkatëse të ILDKPKI-së, si dhe në të dhëna nga institucione shtetërore dhe subjekte të ndryshme private, të administruara në dosjen e Komisionit. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.

14. Lidhur me dyshime të subjektit se në procesin e rivlerësimit të tij, Komisioni është ndikuar nga ekzekutivi dhe ka qenë i anshëm në vendimmarrje për shkak të disa vendimeve të marra nga ana e tij gjatë ushtrimit të funksioneve, trupi gjykues analizon sa vijon.

14.1. Kuadri ligjor që normon procesin e rivlerësimit, dikton që institucionet e rivlerësimit të ushtrojnë funksionet e tyre bazuar në parimet e pavarësisë, paanësisë, barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, për qëllimet e nenit 6/1 të KEDNj-së, ekzistenca e paanshmërisë duhet të përcaktohet sipas testit subjektiv, ku duhet të merret parasysh bindja personale dhe sjellja e një gjyqtari të caktuar, që është, nëse gjykatësi ka pasur ndonjë paragjykim personal ose anshmëri në një çështje të caktuar, dhe testit objektiv, që do të thotë të konstatohet nëse vetë gjykata dhe, sidomos përbërja e saj, ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e saj¹³. Plotësimi nga anëtarët e Komisionit, i deklaratave për mosqenie në kushtet e konfliktit të interesit, konfirmimi për dakordësinë me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe mosparaqitja prej tij e ndonjë pretendimi për anshmëri të trupit gjykues gjatë hetimit administrativ, dëshmojnë për pabazueshmërinë e pretendimeve të subjektit në ankim, lidhur me paragjykime personale apo anësi nga ndonjë anëtar i trupit gjykues të Komisionit.

14.2. Për të mbështetur këtë dyshim, subjekti i rivlerësimit referon në dy vendime të dhëna prej tij si gjyqtar i vetëm, kopje të të cilave ia ka bashkëlidhur ankimit. Trupi gjykues, pa shqyrtuar objektin, palët apo vendimmarrjen lidhur me këto procese gjyqësore administrative, mban në konsideratë se vendimet gjyqësore të gjykatës administrative të shkallës së parë, sikundër janë dy vendimet e referuara prej subjektit, janë të ankimeshme në shkallët më të larta të gjyqimit si shprehje e pavarësisë së pushtetit gjyqësor nga pushtetet e tjera dhe kontrollit hierarkik që kryhet ndaj tyre nga vetë sistemi gjyqësor. Në këtë kontekst, rezulton se vendimi nr. {***}, datë 07.11.2013, është prishur me vendimin nr. {***}, datë 30.01.2014, të Gjykatës së Apelit Administrativ, ndërsa vendimi tjetër nuk ka shënime lidhur me ushtrimin e ankimit apo marrjen formë të prerë të tij, duke mos u evidentuar ndonjë ndërhyrje jashtëligjore në drejtim të kontrollit të tyre apo ndonjë lëvizje me natyrë hakmarrëse apo paragjyquese në drejtim të vetë subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, përderisa në procesin e rivlerësimit të subjektit nuk është përfshirë kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale, dy vendimet e cituara prej tij nuk rezultojnë në asnjë formë të jenë bërë pjesë e vlerësimit apo ndikimit të trupës gjyqësore të Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit, si edhe për të gjithë procesin e tij të rivlerësimit. Në këto kushte, ky pretendim i subjektit mbeti i paprovuar dhe në nivel deklarativ.

14.3 Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka cenuar parimin e barazisë para ligjit, si pasojë e zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar me standarde të dyfishta, në konsideratë të qëndrimit të konsoliduar të Kolegjit¹⁴, një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* një

¹³ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja *Kyprianou kundër Qipros* [GC], nr. 73797/01, paragrafi 118, GjEDNj 2005-XIII dhe *Micallef k. Maltës* [GC], nr. 17056/06, paragrafi 93, ECHR 2009).

¹⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 7, datë 05.04.2019; nr. 34, datë 15.11.2021.

arsye për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit. Çdo vendim i Komisionit, ndaj të cilit ushtrohet ankimi, vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuar nga hetimi administrativ apo gjyqësor, dhe zbatimit korrekt të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra apo standardi i përdorur për të rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni.

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, për shkak se gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, në shkelje të nenit 7 të KEDNj-së, për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike, dhe në shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, për shkak se nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit dhe, për shkak të masës disiplinore, ankuesi ka humbur të gjitha mundësitë për punësim që përkohë me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale.

15.1. Lidhur me pretendimin e subjektit se kërkesat e parashikuara nga ligji për paanësi objektive të trupës gjyqësore të KPK-së, nuk mund të lejojnë që anëtarët e trupës gjyqësore të ushtrojnë si funksione hetimore, ashtu edhe gjyqësore, trupi gjykues sjell në vëmendje faktin se procesi i rivlerësimit kryhet tërësisht nga institucionet e rivlerësimit, organizimi dhe funksionimi i të cilave, përfshirë edhe Komisionin, referon në parashikimet kushtetuese të materializuara në norma të detajuara në ligjin nr. 84/2016. Kuadri ligjor i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese¹⁵ dhe ekspertizës së Komisionit të Venecias¹⁶. Gjykata Kushtetuese, në referim të opinionit të Komisionit të Venecias, ka vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 84/2016, si edhe të kompetencave të organeve të rivlerësimit, në kuptim të përmbajtjes dhe hapësirës ku ato shtrihen, duke u shprehur se: [44]. *Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerëson se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi [...]. [67]. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së¹⁷.*

15.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e emërimit, janë zgjedhur nga një komitet specifik (*ad hoc*) parlamentar dhe janë caktuar nga Parlamenti, pa përfshirjen e trupës gjyqësore, me një procedurë që ka shumë defekte¹⁸, në konsideratë të arsyetimit të GjEDNj-së në çështjen Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë,

¹⁵ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: vendimi nr. 2, datë 18.01.2017 dhe vendimi nr. 78, datë 12.12.2017.

¹⁶ Opinioni CDL - AD (2016)03610.

¹⁷ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017.

Subjekti për këtë shkak ankimi, referon në interpretimin, sipas tij, të vendimit të GjEDNj-së, çështja Volkov kundër Ukrainës; Kartën Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët; raportin e Komisionit të Venecias CDL-AI (2010); Rekomandimin e Këshillit të Ministrave CM/Rec (2010).

vlerësohet nga Kolegji si një argument i zgjidhur tashmë nga jurisprudenca kontrolluese e kësaj gjykate, për pasojë e sheh të panevojshme të argumentojë më tej rreth këtij pretendimi¹⁹.

Lidhur me pretendime të subjektit për shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor, pasi, sipas tij, anëtarët e Komisionit që kanë shqyrtuar çështjen, nuk plotësojnë kushtin e parashikuar në nenin 6, germa “b” e ligjit 84/2016²⁰, apo i ka munguar profesionalizmi dhe eksperiencia e nevojshme për të trajtuar çështjet komplekse dhe të ndjeshme të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se ligji nr. 84/2016 nuk i njuh Kolegjit të Posaçëm i Apelimit kompetenca për të verifikuar përmbushjen e kriterëve kushtetuese dhe ligjore të emërimit në detyrë të anëtarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, brenda shqyrtimit të shkaqeve të një ankimi, për të cilin ka juridiksion kontrollues dhe rishikues.

15.3. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pavarësia e Komisionit është e cenuar dukshëm, për shkak të vlerësimit të rezultateve të punës së anëtarëve të tij nga qeveria²¹, Kolegji sjell në vëmendje vendimin e GjEDNj-së në çështjen Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë, ku gjykata ka arsyetuar se: [...] Gjykata thekson më tej rëndësinë e garancive të parashikuara në legjislacionin e brendshëm, konkretisht, që KPK-ja ka diskrecion të plotë në marrjen e vendimeve për strukturën e saj organizative dhe personelin; nuk merr udhëzime ose orientime nga ekzekutivi. Për më shumë, është vetë KPK-ja që i propozon Parlamentit buxhetin e saj vjetor, pa asnjë ndërhyrje nga ekzekutivi [...]. Fakti që Qeveria i akordoi Komisionit një shpërblim në fund të vitit 2018, si mirënjohje për punën e tij, nuk është në vetvete i mjaftueshëm, sipas opinionit të Gjykatës, për të vënë në dyshim pavarësinë e anëtarëve të tij. Gjykata vëren se KPK-ja ka detyrimin me ligj për të vendosur në mënyrë të pavarur për themelin e secilës çështje, dhe se, siç u tha më lart, kërkesja nuk demonstroi që anëtarët e saj nuk kishin vepruar në mënyrë të pavarur në çështjen e saj [...]. Sikundër GjEDNj-ja arsyeton, parashikimet e ligjit nr. 84/2016 garantojnë pavarësinë e

¹⁹ [...] “Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK ashtu dhe KPA ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj [...] Gjykata më tej përsërit [...] se një organ i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e Nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një “gjykate” në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës, një “gjykatë” karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo gjithashtu duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, “të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutiv, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj [...]” (shih Guðmundur Andri Ástráðsson, cituar më lart, paragrafi 219, dhe referenca cituar aty). Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i “gjykatës” (shih Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës, nr. 40575/10 dhe 67474/10, paragrafi 139, 2 tetor 2018, dhe referencat e cituara në të).

²⁰ Neni 6, germa “b” parashikon se: “[...] 1. Anëtar i Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme [...] b) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës [...] nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës ”.

²¹ Subjekti referon VKM-në nr. 813, datë 31.12.2018.

institucioneve të rivlerësimit. Parashikimet e detajuara në nenin 19²² të tij dhe, më tej, zbatimi i tyre, garantojnë autonominë e institucioneve të rivlerësimit në hartimin e buxhetit me fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit, buxhet i cili miratohet nga legjislativi si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, si dhe pavarësinë e tyre në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara.

15.4. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se rregullat e procesit të rivlerësimit janë në shkelje të parimit të sigurisë juridike për (i) sa kërkojnë të justifikohen bindshëm të ardhura të 32 viteve më parë; (ii) pasaktësitë apo problemet që mund të konstatohen në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim “DIPP”), subjekti nuk mund të shkarkohet nga detyra, pasi, sipas ligjit të kohës 9049/2003, kjo masë parashikohej vetëm në rastet e refuzimit për deklaram, çdo shkelje tjetër kishte sanksion disiplinor dënimin me gjobë, dhe marrja e masës disiplinore për këtë shkak, do të cenonte parimin *nullum crimen, nullum poena sine lege* dhe *mens rea*, trupi gjykues vlerëson si më poshtë.

15.4.1. Kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila, në referim të opinionit të Komisionit të Venecias, ka vlerësuar se: [...] *Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Dhe: 67. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrorjnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...] ²³.*

15.4.2. Gjithashtu, GjEDNj-ja²⁴ ka vlerësuar se: *Sipas këndvështrimit të Gjykatës, duke pasur parasysh që pasuritë personale ose familjare janë akumuluar normalisht gjatë punësimit, vendosja e kufijve të rreptë kohorë për vlerësimin e pasurive do të kufizonte shumë dhe do të cenonte kapacitetet e autoriteteve për të vlerësuar ligjshmërinë e totalit të pasurive të përfituara nga një subjekt gjatë karrierës së tij profesionale. Në lidhje me këtë, vlerësimi i pasurisë manifeston specifika të caktuara, ndryshe nga hetimet e zakonshme disiplinore, të cilat do të kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Kjo është edhe më e vërtetë në kontekstin shqiptar ku verifikimi paraprak i deklaratave të pasurisë nuk kishte qenë veçanërisht efektiv (shih paragrafët 220 dhe 272 më lart). Së fundmi, mund të jetë, gjithashtu, një çështje interpretimi se kur saktësisht një shkelje e veçantë disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë*

²² Neni 19, i titulluar “Buxheti i institucioneve të rivlerësimit”, parashikon: “1. Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta. 2. Institucionet e rivlerësimit propozojnë çdo vit projektbuxhetin e tyre në komisionin që mbulon çështjet ligjore pranë Kuvendit, që e paraqet për miratim në Kuvend, si pjesë integrale të Buxhetit të Shtetit. 3. Institucionet e rivlerësimit zbatohen në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre, të miratuar nga Kuvendi. 4. Institucionet kanë të drejtë të përdorin të ardhurat dytësore, të përfituara nga projektet ndërkombëtare, donacionet dhe botimet e tyre”.

²³ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: vendimet nr. 2, datë 18.01.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017.

²⁴ Vendimi GjEDNj, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafi 349.

kontekst, domethënë, nëse në kohën kur është blerë fillimisht pasuria ose në një pikë të mëvonshme, në kohën kur pasuria është deklaruar në një deklaratë periodike. Në të njëjtën kohë, një fleksibilitet i tillë nuk mund të jetë i pakufizuar dhe implikimet për sigurinë juridike dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6/1 të Konventës duhet të konsiderohen rast pas rasti.

15.4.3. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka interpretuar parimin e sigurisë juridike, si në drejtim të kërkesave individuale me objekt procesin e parregullt ligjor, por dhe në drejtim të shqyrtimit të akteve normative me objekt papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese, duke afirmuar parimin e sigurisë juridike dhe të elementeve kryesore përbërëse, si: pritshmëritë e ligjshme, të drejtat e fituara, ka shkuar më tej, nëpërmjet vënies në dukje të elementeve konkurruese me këtë parim. Interesi publik është një nocion kushtetues i trajtuar disa herë nga kjo gjykatë dhe, sipas interpretimit të saj, është një kriter kushtetues i cili konkurren me sigurinë juridike dhe prevalon ndaj tij. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: [...] *nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjithë elementet e tij thelbësore, ky interes do të ketë natyrshëm përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike*²⁵. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, lidhur me parimin e sigurisë juridike, si parim themelor i shtetit dhe shoqërisë demokratike, ka theksuar se: [...] *Ky parim përfshin midis të tjerave edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përparësi garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore [...]. Gjykata çmon se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit [...]*²⁶. Në këtë kontekst, zbatimi i parimit të sigurisë juridike nuk ka një karakter absolut, por ai është proporcionalisht i kufizuar për shkak të miratimit, nëpërmjet parashikimeve kushtetuese, të rregullave që normojnë procesin e rivlerësimit dhe përcaktojnë edhe kufizimet e posaçme të të drejtave themelore që shkaktohen për shkak të kryerjes së këtij procesi në emër të mbrojtjes së interesit publik.

15.4.4. Bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues sjell në vëmendje se deklaratimet periodike të pasurisë mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, në funksion të provueshmërisë së fakteve të ndryshme që deklarohen si në deklaratën e pasurisë *vetting*, në deklaratat periodike në vite apo gjatë procesit administrativ të rivlerësimit, duke iu nënshtruar një procesi analitik vlerësimi dhe, në këtë këndvështrim, i shërbejnë në tërësi procesit të rivlerësimit për kontrollin e pasurive të subjekteve dhe ligjshmërisë së burimeve për krijimin e tyre. Trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi, sipas tij, nuk mund të shkarkohet për pasaktësitë që mund të konstatohen në deklaratat periodike të pasurisë, pasi në ligjin e kohës, shkarkimi nga detyra parashikohej si masë disiplinore vetëm në rastet e refuzimit për deklaram²⁷, duke qenë se në rastin e subjektit, duket qartë se dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, vjen në përputhje me frymën dhe qëllimin e Kushtetutës dhe të ligjit, për shkelje të tjera që nuk lidhen vetëm me pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike të pasurisë, por, për një sërë problematikash të cilat janë vlerësuar nga Komisioni në këndvështrim të parashikimeve të nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

²⁵ *Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimi nr. 18/2003 dhe vendimi nr. 35/2007.*

²⁶ *Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29/2010.*

²⁷ *Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".*

15.4.5. Lidhur me pretendimin e subjektit se për shkak të masës disiplinore, ka humbur të gjitha mundësitë për punësim, që përkon me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale, nuk mund të ushtrojë profesionin e gjyqtarit apo të prokurorit, nuk mund të aplikojë për një detyrë apo funksion në administratën publike²⁸, nuk mund të jetë noter apo ekspert i pavarur²⁹, si dhe, sipas parashikimeve të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”, gjyqtarët dhe prokurorët e shkarkuar nga procesi i *vetting*-ut nuk mund të marrin titullin e avokatit, madje edhe ata që e kanë marrë mund t’ju hiqet ky titull në ndonjë moment, trupi gjykues sjell në vëmendje arsyetimin e GjEDNj-së lidhur me të njëjtat pretendime të shtruara përpara kësaj gjykate në çështjen Xhoxhaj k. Shqipërisë. Gjykata ka arsyetuar se: *Gjykata vëren më tej se, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra passjell një ndalim të përjetshëm për t’u rifutur në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se gjyqtarët, dhe posaçërisht ata që zënë pozicione që sjellin një shkallë të lartë përgjegjësie, siç janë pozicionet në të cilat kërkuesja dëshiron të rifillojë punësimin, kanë një pjesë të pushtetit sovran të Shtetit. Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (shih, mutatis mutandis, Naidin kundër Rumanisë, nr. 38162/07, 21 tetor 2014, paragrafi 54–55, që kishte të bënte me natyrën absolute të ndalimit të një ish-bashkëpunëtori të policisë politike për t’u punësuar në shërbimin publik; për kontrast, Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, nr. 55480/00 dhe 59330/00, paragrafi 58, Gjykata 2004 VIII; Rainys dhe Gasparavičius kundër Lituanisë, nr. 70665/01 dhe 74345/01, paragrafi 36, 7 prill 2005; dhe Žičkus kundër Lituanisë, nr. 26652/02, paragrafi 31, 7 prill 2009, në lidhje me kufizimet e një personi për të gjetur punë në sektorin privat). Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses.*

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

16. *Lidhur me shkakun e ankimit se “vendimi i Komisionit është i pabazuar dhe alogjik pasi nxjerr një diferencë të pambuluar të pasurisë, pothuajse sa vlera e pasurisë, edhe pse vlera e pasurisë të z. Shema është vetëm 29% e të ardhurave të tij të ligjshme”, trupi gjykues sjell në vëmendje se metodologjia e analizës financiare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, i referohet momentit të krijimit të pasurisë³⁰. Në bazë të kësaj metodologjie, vlerësohet në mënyrë objektive saktësia e deklaramentit nga ana e subjektit, sikundër edhe mjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë në momentin e krijimit³¹, si edhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës. Pretendimi i subjektit, bazuar në përllogaritjet totale të të ardhurave të gjithë periudhës, përkundrajt vlerës totale të gjithë pasurive të deklaruara prej tij në deklaratën *vetting*, nuk është objektiv dhe i bazuar, vjen*

²⁸ Subjekti referon parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

²⁹ Subjekti referon parashikimet e neneve 5 dhe 23 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.

³⁰ Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPI-së, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklaramentit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³¹ Vendimi GjEDNj, çështja Xhoxhaj kundër Shqipërisë.

në kundërshtim me logjikën e ligjit dhe metodologjinë e zbatuar gjatë procesit të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, të pabazuar në ligj.

Për pasurinë truall me sipërfaqe 500 m², në Tiranë, në bashkëpronësi (Astrit Shema, K. B. , F. B., Sh. M.)

17. Lidhur me pretendimin për konkluzion të gabuar të Komisionit se *deri në datën 28.02.2002, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 899.043 lekë, dhe se dy prej personave të tjerë të lidhur, F. B. dhe Sh. M. , nuk paraqitën dokumentacion ligjor justifikues për burimin e krijimit të truallit me sipërfaqe 500 m², në bashkëpronësi, në Tiranë, si pasojë e mosllogaritjes së drejtë: (i) të shpenzimeve të jetesës për periudhën 1998-2002: (ii) të shpenzimeve për arredimin e apartamentit në Përmet; (iii) të të ardhurave nga pagat të subjektit dhe të bashkëshortes së tij; si dhe të interpretimit të gabuar të ligjit lidhur me cilësimin persona të tjerë të lidhur, të shtetasve F. B. dhe Sh. M. , trupi gjykues analizon si vijon.*

17.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se përllogaritja e shpenzimeve të jetesës të periudhës 1988-2002, duhet të bazohet në metodologjinë e përdorur nga eksperti në aktekspertimin financiar të paraqitur prej tij³², sipas të cilit pësia specifike e zërit të shpenzimeve për jetesë, për periudhën 2003-2016, periudhë e cila, sipas tij, ka përqindjen më të lartë të këtij zëri, prej 42%, të përdoret për të llogaritur edhe shpenzimet e jetesës përpara vitit 2003. Komisioni, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe shpjegimeve të subjektit, ka vlerësuar se referenca prej 42% nuk mund të përdoret për të përllogaritur shpenzimet e jetesës së kësaj periudhe, për shkak të kushteve ekonomike dhe historikut të normave të interesit në Shqipëri deri në vitin 1999, duke evidentuar me poshtëshënim publikimet referuese³³. Ndërsa, për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në vitet 2000, 2001, 2002, Komisioni është bazuar në shkresën e ILDKPI-së³⁴ (për vitet 2000, 2001, në mungesë të të dhënave, është marrë referencë viti 2002). Për sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se përllogaritja e Komisionit *nuk është bazuar në të dhëna konkrete*. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, se për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi për shkak të ndryshimeve të sistemit qeverisës, të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, janë të papërfillshme në drejtim të konsiderimit të mundësisë së kursimit prej tyre në nivel të tillë që të përballojnë shpenzimet për blerjen e pasurive në vlera shumëfish më të mëdha se vetë të ardhurat totale të individëve, për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare³⁵, pretendimi i subjektit se konkluzioni i Komisionit nuk është bazuar në analizë me logjikë ekonomike, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar. Në analizën financiare të kryer në Kolegji, të ardhurat e kësaj periudhe u konsideruan se nuk kanë relevancë për krijimin e ndonjë kursimi sipas logjikës së përshkruar më lart.

17.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se për periudhën 1.12.1988 - 1.12.1993, të ardhurat e tij nga paga si inxhinier gjeolog në Minierën e Qymyrgurit Memaliaj [nën tokë] janë në shumën

³² Akti i ekspertimit financiar mbi të cilin subjekti bazoi këtë pretendim, është paraqitur prej tij në Komision në përmbushje të barrës së provës, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ.

³³http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/id/71/titull/Historik_i_Inflacionit_ne_Shqiperi/Historik-i-Inflacionit-ne-Shqiperi.

³⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 4.03.2019.

³⁵ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 14, datë 09.07.2019.

555.000 lekë, dhe jo në shumën e përlogaritur nga Komisioni prej 282.780 lekësh, se Komisioni nuk ka dhënë asnjë shpjegim se në cilin dokument zyrtar është referuar për përlogaritjen e pagës së tij të kësaj periudhe, si dhe për pretendimin se Komisioni nuk ka përlogarit saktë të ardhurat e bashkëshortes nga paga për periudhën 4.09.1990 - 1.10.1992, trupi gjykues konstatoi si vijon.

17.2.1. Subjekti, në përmbushje të barrës së provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit administrativ për mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën 1.195.624 lekë, për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive ku përfshihet edhe blerja e këtij trualli në datën 28.02.2002, ka paraqitur kopje të noterizuar të librezës së tij të punës dhe të librezës së punës të bashkëshortes. Komisioni, për periudhat e punësimit të vërtetuara sipas librezave të punës, në mungesë të dokumentacionit provues për vlerën e pagës, ka përlogaritur pagën për subjektin dhe bashkëshorten e tij, bazuar në pagat referuese sipas VKM-së nr. 561, datë 12.08.2005. Në pozicionet e punës të përcaktuara në këtë akt nënligjor, nuk rezultoi i përfshirë ai i inxhinierit, dhe vlera prej 4.713 lekësh, e përlogaritur nga Komisioni për pagën e subjektit si inxhinier, i referohet llojit të punës *kryeinxhinier, kryeagronom, kryegjeolog e të tjerë të kësaj kategorie – për administratën e ndërmarrjeve*, një pozicion pune më të lartë, për të cilin gjithashtu akti nënligjor nuk përcakton nëndrejtime specifike sipas profilit apo vendit të punës. Në këtë akt nënligjor, ku paga referuese në vlerën më të lartë, prej 8.220 lekësh, përcaktohet ajo e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, vlera e deklaruar prej subjektit për pagën e tij si inxhinier gjeolog nëntokë, prej 9.000 lekësh apo 8.500 lekësh, nuk rezultoi e përcaktuar si pagë referuese për asnjë nga pozicionet e punës të përfshira. Në mungesë të dokumentacionit provues, përcaktimet e aktit nënligjor, dalë në bazë të ligjit me objekt rregullimi marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë, kapilarizojnë zbatimin e normave ligjore për periudhën para datës 1.01.1994, duke përcaktuar pagat referuese mujore të ndara sipas pozicioneve të punës dhe, në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, për përlogaritjen e të ardhurave bazuar te pagat e referencës, në kushtet e mungesës së dokumentacionit provues, pretendimet e subjektit, të cilat nuk rezultojnë as në nivel të përafërt me pagat referuese të para vitit 1994, mbeten në kuadrin e deklarimeve të pambështetura dhe të paprovuara. Trupi gjykues, për sa arsyetuar në paragrafin 17.1 të këtij vendimi, vlerëson se të ardhurat e subjektit nga paga, për periudhën 1.12.1988 - 1.12.1993, pavarësisht vlerës së pagës, nuk kanë peshë në konsiderim të mundësisë për të përballuar shpenzimet dhe të kursimit për blerjen e pasurive në vlera shumëfish më të mëdha se vetë të ardhurat totale familjare.

17.2.2. Lidhur me pretendimin e subjektit për pagën e bashkëshortes në vlerën 253.500 lekë, për periudhën 4.09.1990 - 1.10.1992, në ish-Ndërmarrjen e Grumbullimit Tepelenë, rezultoi se edhe në këtë rast, për pozicionin dhe periudhën e punës të vërtetuar nga librezat e punës, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion për vërtetimin e pagës së përfituar prej saj. Për sa analizuar në pikën 17.1, pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat nga paga e bashkëshortes për këtë periudhë, mbeten në nivel pretendimi, përkundëjt vlerës së përlogaritur nga Komisioni, bazuar në pagën referuese sipas përcaktimeve të VKM-së të datës 12.08.2005 dhe me të njëjtën peshë në analizë si edhe pagat e subjektit për periudhën deri në vitin 1992.

17.3. Lidhur me pretendimet e subjektit se shifra prej 5000 eurosh³⁶, si shumë e shpenzuar për arredimin e apartamentit në Përmet, është deklaruar prej tij si llogaritje të përafërt e mobilieve që

³⁶ Subjekti, për zërin “Shpenzime për arredimin e shtëpisë në Përmet”, apartament të cilin e ka fituar me statusin si i pastrehë në vitin 1996, ka deklaruar: (i) në pyetësorin standard: “për arredimin e tij, të kryer qysh kur kam hyrë në të, më ka kushtuar rreth 5000 euro”; (ii) në pyetësorin nr. {***}, përmes të cilit i është kërkuar të specifikojë vlerat e

ndodhen në banesë, referuar çmimeve në momentin e kthimit të përgjigjes, pasi, për shkak të periudhës mbi 20 vjet nga momenti i blerjes, nuk mban mend çmimet e blerjes së tyre, trupi gjykues analizon si vijon.

17.3.1. Subjekti i rivlerësimit, pretendimin se vlera e shpenzimeve për arredimin e apartamentit në Përmet, nuk ka qenë 5.000 euro, e mbështet edhe në faktin se në vitin 1996, monedha euro nuk kishte hyrë në qarkullim. Trupi gjykues e vlerëson jorelevant këtë pretendim, duke analizuar se: (i) pyetja e adresuar nga Komisioni përmes pyetësorit 2, për *specifikim të vlerave të shpenzuara për mobilim për çdo vit*, përcakton qartë referimin në vitet e kryerjes së shpenzimit. Në kontekst të qartësisë së pyetjes dhe rideklarimit në këtë pyetësor të vlerës së shpenzimit në monedhën euro, sikundër edhe në pyetësorin standard, pretendimet e subjektit, të bazuara në historikun e monedhës euro, nuk janë relevante për sa vetë ai ka zgjedhur të deklarojë vlerën e shpenzimeve të mobilimit në këtë monedhë.

17.3.2. Subjekti i rivlerësimit ka dëshmuar mungesë konsistence në deklaratimet lidhur me këtë shpenzim dhe llogaritja e vlerës së këtij shpenzimi, sipas çmimeve të tregut në momentin e deklaratimit, është pretenduar nga subjekti vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, moment në të cilin konstatohet ndryshimi i qëndrimit të tij edhe për periudhën e kryerjes së arredimit. Në ndryshim nga sa shpjeguar prej tij në pyetësorë, se arredimi i këtij apartamenti është kryer nga viti 1996, në seancën dëgjimore, sikundër edhe në ankim, subjekti deklaroi se pjesa më e madhe e këtij mobilimi është sjellë nga banesa e mëparshme ku banonte me bashkëshorten prej vitit 1991. Shkalla e njohjes që subjekti dëshmon për procesin e rivlerësimit në tërësi, normat, rregullat dhe metodologjinë për kryerjen e tij nga organet e rivlerësimit të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, përmes parashtrimeve në ankim, prapësimeve për rezultatet e hetimit administrativ, si dhe çdo komunikimi përgjatë hetimit administrativ, përjashton mundësinë e paqartësive në lidhje me rëndësinë e deklaratimeve të kryera prej tij në procesin e rivlerësimit, specifikisht të shpenzimeve të pamundura të konfirmohen nga organet e rivlerësimit me deklaratat periodike vjetore të përpara vitit 2012³⁷. Në konsideratë të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji³⁸, duke theksuar se për qartësimin e situatës faktike për këto shpenzime, saktësia dhe konsistenca e deklaratimeve mbetet e rëndësishme dhe është përgjegjësi e vetë subjektit, përkundrejt ndryshimit të deklaratimeve që krijojnë dyshim të arsyeshëm se kanë ndodhur në funksion të përmirësimit të situatës financiare, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar këtë pretendim të subjektit.

shpenzuara për mobilim për çdo vit: “Në lidhje me shpenzimet e mobilimit për banesën në qytetin e Përmetit, për të cilën unë kam deklaruar se qysh nga fillimi dhe deri më sot, kanë shkuar rreth 5000 euro, theksoj se mobilimi i saj është bërë qysh nga viti i hyrjes në të, 1996, dhe është një mobilim modest, ku nuk ka asnjë lloj pajisjeje që të kalojë shumën mbi 1000 euro. Mobilimi i saj është bërë para vitit 2000 dhe nuk disponoj fatura shpenzimi të kryera për këtë banesë; (iii) në prapësimet në seancë dëgjimore: “për t’iu përgjigjur pyetjeve tuaja mbi vlerën e arredimit të banesës në vitin 1996, unë kam kryer një përlllogaritje të përafërt të mobilieve që ndodhen në atë banesë, referuar çmimeve në momentin e kthimit të përgjigjes [...] kjo mënyrë e të menduarit nga ana ime, në momentin e kthimit të përgjigjes, mund të konstatohet lehtësisht si e tillë, duke pasur parasysh se në vitin 1996 nuk ka pasur në qarkullim monedhë euro dhe as kurs këmbimi të saj [...] vlera e një mobilimi modest nuk mund të jetë 668.250 lekë [...] pjesa më e madhe e mobilimit të kësaj banese është sjellë nga banesa ime e mëparshme, ku banoja me bashkëshorten prej vitit 1991 [...]. Pavarësisht këtij fakti, edhe sikur vlera e mobilimit të merrret e tillë, ashtu si edhe eksperti kontabël ka vepruar, të ardhurat e mia gjatë kësaj periudhe janë të mjaftueshme dhe mbulojnë vlerën e pasurisë gjatë kësaj periudhe”.

³⁷ Deri në vitin 2012, kuadri ligjor që ka rregulluar kontrollin dhe deklarimin e pasurive të subjekteve që bartin detyrim për deklarim të pasurive, nuk përcaktonte detyrim për deklarime të shpenzimeve nën 500.000 lekë, përfshirë edhe shpenzimet për arredim.

³⁸ Shih vendimet e Kolegjit nr. 25, datë 29.07.2021; nr. 16, datë 26.05.2022.

17.4. Lidhur me pretendimin e subjektit se shtetasit F. B. dhe Sh. M. nuk janë persona të tjerë të lidhur, trupi gjykues, në këndvështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë statusin e personave të tjerë të lidhur, shqyrtoi dhe vlerësoi rrethanat e faktit të rezultuara nga hetimi sa i përket pasurisë truall me sipërfaqe 500 m², në bashkëpronësi, ndërlidhur me konkluzionet e Komisionit për bashkinvestimin në ndërtimin e ndërtesës së ngritur në këtë truall, duke qenë se, bazuar në këto dy situata faktike, Komisioni ka kualifikuar bashkëpronarët në blerjen e truallit dhe bashkinvestitorët në ndërtimin e godinës në këtë truall, persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

17.4.1. Komisioni në vendim ka analizuar se: (i) gjatë hetimit, u vërtetua se nuk është bërë ndarja e pjesëve takuese në godinën në bashkëpronësi 4 kate + 1 kat; në këto kushte, katër bashkëpronarët rezultojnë bashkinvestues lidhur me blerjen e truallit dhe ndërtimin e bërë mbi këtë truall, duke vërtetuar në këtë mënyrë ekzistencën e interesit pasuror mes subjektit dhe bashkëpronarëve të tjerë, duke plotësuar kërkesat e pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016; (ii) rezulton e provuar se shtetasit F. B. dhe K. B. , në cilësinë e bashkëpronarëve të ndërtesës 4 kate + 1 kat, pjesën që do t'u përkiste në katin përdhes, e kanë kaluar në emër të subjektit pa asnjë pretendim pronësie, duke e bërë subjektin pronar me 3/4 pjesë në katin përdhes. Për sa rezulton, është dhuruar edhe pjesa e truallit të sipërfaqeve takuese, pasi nuk ka asnjë provë që të provojë kompensimin e vlerës së truallit dhe të pjesëve takuese, nga të cilat dy bashkëpronarët kanë hequr dorë. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe mbart detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë objekt dhurimi; (iii) në DIPP-në e vitit 2003, në seksionin III, subjekti i ka deklaruar këta shtetas persona të tjerë të lidhur në kundërshtim me sa pretendon në prapësime.

Bazuar në këtë analizë, Komisioni ka hetuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit z. K. B. dhe z. F. B. , për shkak të dhurimit të pjesës prej 1/4 në katin përdhes të godinës 5-katëshe dhe bashkinvestimit në godinën 5-katëshe; dhe z. Sh. M. për shkak të bashkinvestimit në godinën 5-katëshe.

17.4.2. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me z. K. B. , z. F. B. , z. Sh. M.³⁹, nuk ka pasur asnjë lloj lidhjeje interesi pasuror apo çdo lloj marrëdhënieje tjetër biznesi, përveç lidhjes fisnore, dhe ka dhënë shpjegime për investimin e tyre në blerjen e truallit dhe ndërtimin e godinës në këtë truall. Në përmbushje të barrës së provës, edhe pse ka mbajtur të njëjtin qëndrim se këta persona nuk janë persona të tjerë të lidhur, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të tyre për blerjen e truallit (pjesës takuese) dhe investimit në godinën në bashkëpronësi (pjesës takuese).

17.4.3. Sipas vërtetimit të lëshuar nga ZRPP Tiranë, më datë 10.09.2003, në regjistrin hipotekor me nr. 64/8190, datë 26.2.2003, figuron e regjistruar në pronësi të z. F. B. , z. K. B. , z. Astrit Shema, z. Sh. M. , pasuria me nr. {***}, ZK {***}, truall me sipërfaqe 500 m², i ndodhur në rr. "Labinoti". Sipas kontratës së shitblerjes⁴⁰, subjekti dhe tre shtetasit e sipërpërmendur, përkundrejt çmimit të shitblerjes prej 3.900.000 lekësh, kanë blerë truallin 500 m², në pjesë të barabarta, nga 1/4 secili.

³⁹ Subjekti në DIPP 2003, i ka deklaruar të tre bashkinvestitorët për blerjen e truallit në rubrikën "Persona të tjerë të lidhur në pasuri të përbashkët me mua".

⁴⁰ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 5.03.2002, notere Sh. K., Dhoma e Noterisë Tiranë.

17.4.4. Sipas informacionit të përcjellë nga ALUIZNI⁴¹, për subjektin dhe tre bashkinvestitorët [F. B. , K. B. , Sh. M.] është emtuar leja e legalizimit⁴² për objektin godinë e kombinuar 5 kate, me sipërfaqe totale 960,4 m² [162,4 m² sipërfaqe e katit përdhes, i pashfrytëzuar, dhe 798 m² sipërfaqe totale e ndërtimit për banim], ndërtuar në truall në pronësi të vetëdeklaruesit⁴³.

17.4.5. Sipas informacionit të përcjellë nga ZVRPP Tiranë⁴⁴, konfirmohet se *Astrit Shema ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë me të dhënat 1- Pasuria nr. {***}, vol. {***}, faqe {***}, Zona Kadastrale {***}, lloji i pasurisë truall me sipërfaqe 500 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 162,4 m², leje legalizimi godinë banimi 5 kate, sipërfaqe totale 798 m², në bashkëpronësi me F. B. , K. B. , Sh. M. (pasuri aktive).*

17.4.6. Subjekti, në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, ka deklaruar në pronësi të tij $\frac{3}{4}$ e katit përdhes dhe ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasve K. B. dhe V. B.⁴⁵, si edhe deklaratën noteriale të shtetasit F. B.⁴⁶ për provueshmërinë e pjesës takuese të deklaruar prej tij në këtë kat. Përmes këtyre deklaratave noteriale, “Për heqje dorë nga pronësia”, secili prej shtetasve të sipërcituar ka deklaruar se: *pjesa ime ideale që do të më përkiste në katin përdhes, do të investohej nga djali i dajës tim, Astrit Shema, dhe bashkëpronari tjetër, z. Sh. M.. Këtë deklaratë e jap me kërkesë të tij, me qëllim që ai ta paraqesë përpara ZRPP Tiranë, për regjistrim të pjesës sime ideale në emrin e vet, pasi unë nuk kam asnjë pretendim pronësie mbi atë pjesë.*

17.4.7. Trupi gjykues, në analizën që i bën situatës faktike lidhur me kualifikimin ligjor të statusit të bashkinvestitorëve në një pasuri të përbashkët, për llogari të procesit të rivlerësimit, mban në konsideratë trajtimin ligjor të kryer prej Kolegjit në rastet precedente, sipas të cilit, kur nga hetimi administrativ nuk rezulton asnjë gjetje mbi bazën e së cilës mund të ngriheshin dyshime të arsyeshme në lidhje me përfshirjen reale të këtyre personave në investim, d.m.th. dyshime për fshehje nga ana e subjektit të rivlerësimit të pasurisë së tij në emër të këtyre bashkinvestitorëve, kualifikimi si persona të tjerë të lidhur i bashkinvestitorëve, nuk është i bazuar në ligj⁴⁷. Në vijim të këtij qëndrimi, për sa kohë vlera e investimit të subjektit në ndërtimin e godinës, sipas deklarimit

⁴¹ Shkresa nr. {***}, datë 13.03.2009.

⁴² Leja e legalizimit nr. {***}, datë 12.09.2013.

⁴³ ALUIZNI, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.09.2013, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 9482/2006 dhe vërtetimit të pronësisë së pasurisë me nr. {***}, ka dërguar pranë ZRPP dokumentacionin tekniko-ligjor të ndërtimeve informale të legalizuara, të gatshëm për t'u regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

⁴⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 20.11.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵ Nr. {***} rep./nr. {***} kol., datë 24.01.2017, notere M. Sh., Dhoma e Noterisë Tiranë, ku deklarohet: “[...] kemi ndërtuar me bashkëpronarët e tjerë së bashku një banesë (4+1) kate për banim. Kemi hedhur shortin dhe secili nga ne ka marrë katin që i ka rënë sipas shortit. [...] Kemi realizuar procedurat paraprake të deklarimit të banesës për efekt të legalizimit në mbështetje të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 [...] aktualisht jemi në fazën e përfundimit të kësaj procedure, ku për efekt të legalizimit, kemi përcaktuar katin e banimit për secilin bashkëpronar në këtë banesë. Për sa i përket katit përdhes, deklaroj nën përgjegjësinë time dhe me vullnet të lirë se kemi rënë në marrëveshje që kur filloi ndërtimi i banesës, se pjesa ime ideale që do të më përkiste në katin përdhes, do të investohej nga djali i dajës tim, z. Astrit Shema, dhe bashkëpronari tjetër, z. Sh. M. Këtë deklaratë e jap me kërkesë të tij, me qëllim që ai ta paraqesë përpara ZRPP Tiranë, për regjistrim të pjesës sime ideale në emrin e vet, pasi unë nuk kam asnjë pretendim pronësie mbi atë pjesë, regjistrim i cili do të kryhet në konformitet me nenin 49 të ligjit 9482, datë 3.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, në lidhje me nenin 41 të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, me titull “Regjistrimi i pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi”, dhe nenin 43, me titull “Regjistrimi i pjesëtimit të një pasurie të paluajtshme që është në bashkëpronësi”.

⁴⁶ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2017, notere M. Sh., Dhoma e Noterisë Tiranë, me të njëjtën përmbajtje sikundër në poshtëshënimin 40.

⁴⁷ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 14, datë 15.06.2021.

të tij në deklaratën e rivlerësimit *vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë periodikë (i) është përpjesëtimore me pjesën e pronësisë së tij ideale dhe e përafërt me vlerat e investimit të deklaruara prej tij për bashkëpronarët e tjerë; (ii) dhe në vendimin e Komisionit, nuk ka asnjë gjetje për të cilën të ngriheshin dyshime për fshehje nga ana e subjektit të pasurisë në emër të bashkinvestitorëve; (iii) secili prej bashkëpronarëve ka investuar dhe gëzon në përputhje me investimin pjesët e tij takuese, pa kaluar ndonjë e drejtë te subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se situata faktike nuk mund të kualifikohet si ajo e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe se shtetasit F. B. , K. B. dhe Sh. M. nuk konsiderohen si persona të tjerë të lidhur, për të cilët lind detyrimi për justifikimin e burimeve të ligjshme.

17.4.8. Lidhur me pretendimet e subjektit se z. K. B. dhe z. F. B. nuk i kanë dhuruar atij asgjë, dhe se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit që këta shtetas kanë kaluar në emër të subjektit, pa asnjë pretendim pronësie, pjesën që do t'u përkiste në katin përdhes, duke e bërë subjektin pronar me 3/4 pjesë në këtë kat, trupi gjykues analizoi situatën faktike për t'u dhënë përgjigje çështjeve: (i) deklarata noteriale për heqje dorë nga pronësia, e paregjistruar, a i kualifikon deklaruesit persona të tjerë të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (ii) deklarimi i heqjes dorë nga pronësia në pjesën ideale në katin përdhe, ka ndikim në raportin e pronësisë të truallit për t'i kualifikuar këta shtetas si persona të tjerë të lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016⁴⁸; (iii) deklarimi i subjektit se ai gëzon 3/4 e katit përdhe për shkak të investimit të tij personal në këtë masë dhe verifikimi i burimeve për financimin e kësaj pjese takuese, a e zgjidh çështjen e kontrollit të pasurisë për efekt të këtij procesi.

17.4.8.1. Referuar në dispozitat e kreut II të Kodit Civil, ku janë përkufizuar e rregulluar mënyrat e fitimit të pronësisë, pozicionohet edhe neni 191, i cili, pavarësisht se është në vijueshmërinë e evidentimit kronologjik të mënyrave të fitimit të pronësisë, ndryshe nga dispozitat e tjera të këtij kreu, emërtohet “humbja e pronësisë” dhe përcakton se: *Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj. Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohet.* Nga aktet e administruara në dosjet e Komisionit, nuk rezulton që vullneti i manifestuar nga shtetasit K. B. dhe F. B. , përmes aktit noterial, për t'i dhënë fund marrëdhënies së tyre të pronësisë në pjesën takuese në katin përdhe, të jetë regjistruar duke mos provuar realizimin e efektit të synuar për ndryshimin e raporteve të pronësisë sa i përket katit të parë të godinës, aktualisht në bashkëpronësi, në raport me të tretët, përfshi këtu edhe institucionet e rivlerësimit.

17.4.8.2. Në deklaratat noteriale, shtetasit e sipërcituar shprehen vetëm për heqje dorë nga pjesa ideale takuese në katin përdhe të godinës, pa u shprehur lidhur me pjesët takuese në truallin në të

⁴⁸ Referuar dokumentacionit të praktikës së legalizimit, rezulton e depozituar deklarata e nënshkruar e bashkinvestitorëve [...] në kuadër të procesit të legalizimit të ndërtimeve informale me administratën e ALUIZNI-t Tiranë [...], në përmbajtje të së cilës pasqyrohet: “[...] ndërtesën e përbashkët 4+1 kate, [...] e kemi ndërtuar me kontribut të përbashkët, me destinacion kryesor: banesë familjare (secili nga ne një kat banimi, përkatësisht: F. B. kati i parë i banimit, 2. Sh. M., kati i dytë i banimit, 3. Astrit Shema , kati i tretë i banimit, 4. K. B., kati i katërt i banimit), kurse **kati përdhes** i kësaj ndërtese është në bashkëpronësi në pjesë të pandara dhe me destinacion në funksion të banimit në këtë banesë dhe **dëshirës së pronarit mbas ndarjes së pjesëve**, si: magazinë/garazh/dyqan. Njëkohësisht oborri në [...] të kësaj banese, është në bashkëpronësi”.

cilin është ngritur godina. Nga leximi harmonik i neneve 209⁴⁹ dhe 210⁵⁰ të Kodit Civil, e drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet në bashkëpronësi të detyrueshme, ku përfshihet edhe trualli, është në përpjesëtim me vlefshëm të katit ose pjesëve të katit që i përkasin atij. Në këtë këndvështrim, përcaktimi i pjesëve në marrëdhënien e bashkëpronësisë së detyrueshme, për shkak të parashikimit ligjor, është një rregull i cili zbatohet në rastet kur ajo lind për shkak të bashkëpronësisë mbi objektin e ngritur mbi truall, në ndryshim nga rasti objekt shqyrtimi, në të cilin bashkëpronësia mbi truallin ka lindur si pasojë e një marrëveshjeje mes palëve, e cila, me vullnet të përbashkët, ka përcaktuar edhe pjesët takuese mes tyre. Ndryshimi i këtyre pjesëve në këtë rast, siç edhe përcaktimi i tyre, do të lindte nga një marrëveshje tjetër mes tyre dhe jo për shkak të zbatimit të ndonjë parashikimi të detyrueshëm ligjor. Në këto rrethana, për sa kohë që nuk rezulton që kjo marrëveshje të ketë ndodhur, hipoteza për të ardhmen e kësaj marrëdhënieje nuk mund të jetë një bazë e arsyeshme dhe logjike për të ndërtuar faktet procedurale mbi të cilat zgjidhet kjo çështje.

17.4.8.3. Përveç sa më lart, subjekti ka pretenduar se për shkak të faktit se shtetasit K. e F. B. kishin hequr dorë prej së drejtës së tyre për të investuar në katin përdhe që në fazën ndërtimore, ky investim është kryer prej vetë subjektit me mjetet e tij financiare. Në këtë logjikë, sipas pretendimit të tij, Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësitë e subjektit për të justifikuar me burime të ligjshme ndërtimin e pjesës së tij takuese në objekt, duke përllogaritur në katin përdhe pjesën takuese të tij prej $\frac{3}{4}$ sipas vetëdeklarimit të subjektit. Në të njëjtën linjë, ka vijuar kontrollin për burimin e financimit të këtyre burimeve edhe Kolegji, duke ezauruar në këtë mënyrë kontrollin shterues të burimeve të ligjshme për pasurinë e subjektit sipas parashikimit të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës. Qëllimi i verifikimit të burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur për të krijuar pasuri sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, rrjedh nga detyrimi kushtetues për provueshmërinë e çdo burimi të ligjshëm që ka krijuar pasurinë në pronësi të subjekteve dhe, për sa kohë që ky verifikim kryhet drejtpërdrejt mbi burimet e vetë subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë shërbyer për krijimin e një pasurie, atëherë në vlerësimin e Kolegjit, qëllimi kushtetues është realizuar.

17.4.8.4. Sa më sipër, duke qenë se: (i) në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit, për sa deklarata e shtetasve K. B. dhe F. B. nuk është regjistruar në regjistrat e ZRPP-së, heqja dorë nga pronësia nuk konsiderohet e vlefshme në kuptim të Kodit Civil, për rrjedhojë as pjesa ideale takuese e këtyre shtetasve në katin përdhes, nuk ka kaluar në pronësi formale të subjektit; (ii) nuk rezulton që të kenë ndodhur ndryshime në pjesët takuese të bashkëpronësisë mbi truallin; (iii) rezulton se është verifikuar mundësia financiare e vetë subjektit për të përballuar investimin në pjesën prej $\frac{3}{4}$ në katin përdhe të godinës; trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e këtyre shtetasve me subjektin e rivlerësimit nuk kualifikohet sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe shtetasit e mësipërm nuk kualifikohen si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe nuk mbartin as ata dhe as subjekti detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të

⁴⁹ Neni 209, “Objektet e përbashkëta të ndërtesave”, përcakton se: “Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte: a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose tarraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët; b) puset, instalimet e ujit, instalimet elektrike, të gazit, të telefonisë e të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe tubacionet dhe linjat përkatëse, si dhe kanalet e ndryshme deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njësite të ndara të kateve”.

⁵⁰ Neni 210: “E drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vlefshëm të katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe [...]”.

krijimit të pasurive në pronësi të këtyre shtetasve apo të krijimit në ndonjë mënyrë të mundësisë ideale për të investuar në pjesët respektive në katin përdhe, për sa kohë që subjekti i është nënshtruar kontrollit të burimeve për pjesët e deklaruara në pronësi të tij në mënyrë të plotë, mbi të gjitha të ardhurat e tij të përdorura për krijimin e kësaj pasurie.

17.4.8.5. Në konkluzion, lidhur me pasurinë truall me sipërfaqe 500 m², në bashkëpronësi me shtetasit K. B. , F. B. dhe Sh. M. , të ndodhur në qytetin e Tiranës, pas analizës financiare të kryer në Kolegj, duke reflektuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e jetesës, sërish subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie deri në datën 28.02.2002 dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera familjare në vlerën prej - 481.116 lekësh, situatë faktike e cila kualifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasurinë e paluajtshme 4 kate +1 kat, në bashkëpronësi (Astrit Shema, K. B. , F. B. , Sh. M.), në qytetin e Tiranës.

18. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe është përpjekur të fshehë fakte të rëndësishme për pasuritë në pronësi të tij, si dhe ka bërë deklaram të rremë në lidhje me datën e fillimit të punimeve të godinës*, duke pretenduar se (i) ka deklaruar me përgjegjësi pagesat dhe investimin për pjesën e tij takuese, sipas vlerave të deklaruara me vërtetësi në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, të cilat kanë vlerë provuese në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (ii) investimi fillestar për ndërtimin e objektit është kryer në vitin 2005 dhe nuk ka lidhje me fillimin e punimeve.

18.1. Subjekti, në deklaratën *vetting*, nuk ka deklaruar lidhur me kohën e fillimit të punimeve të godinës 4 kate + 1 kat, ndërsa në DIPP 2005, për herë të parë, deklaroi: *Ndërtim i banesës në bashkëpronësi (në truallin e deklaruar më parë pranë ish-vilave gjermane). Ndërtim i kryer gjatë vitit të deklarimit.* Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë shpjegime të ndryshme lidhur me fillimin e punimeve të ndërtimit, asnjëri prej të cilëve nuk përputhej me deklarin e tij në vitin 2005. Konkretisht, në përgjigje të pyetësorit 2: *me realizimin e kontratës së shitblerjes së truallit më datë 05.03.2002, jo në mënyrë të menjëhershme, ka filluar ndërtimi/investimi [...] fillimisht është kryer identifikimi i pronës në terren, pastrimi i vendit [...] duke kryer njëkohësisht edhe pozicionimin e gropës së projeksionit të bazës ndërtimore dhe thurjen e saj me disa bandiera betoni dhe tel. Në fund të vitit 2004, jemi përpjekur për nxjerrjen e lejes së ndërtimit [...] por nuk është bërë e mundur. Unë personalisht kam qenë me idenë që të prisnim për të filluar punimet pasi të dilte leja [...] por nga bashkëpronarët/bashkinvestuesit është marrë vendimi që në muajin nëntor-dhjetor të fillojnë punimet për ndërtimin e strukturës beton arme të objektit [...]; në pretendimet për rezultatet e hetimit administrativ: sikurse është konstatuar edhe nga ju nëpërmjet “ortophoto” në “google”, gërmimi për themelet ka filluar në vitin 2003, por nga ana ime gjatë këtij viti dhe gjatë vitit 2004 nuk është kryer ndonjë pagesë. Duke pasur parasysh këtë fakt, nuk kisha si të deklaroja një shpenzim që nuk e kisha realizuar [...] të dhënat e pasqyruara në DPV e vitit 2003 dhe 2004 [...] përbëjnë provë të plotë [...] pamjet në “google” jo vetëm që nuk janë dokumente zyrtare, por kurrsesi ato nuk mund të shërbejnë për të provuar kur janë kryer pagesat nga ana ime.*

18.2. Në referim të akteve të administruara në dosjen e legalizimit të objektit⁵¹, nga vetëdeklarimet e subjektit dhe të bashkinvestitorëve, përcaktohet periudha e fillimit të punimeve, maj 2002. Komisioni ka vlerësuar si kohë të fillimit të punimeve vitin 2003, duke qenë se nga pamjet që vijnë nga *ortophoto* e këtij viti, gjenden gjurmë të hedhjes së themeleve të objektit në këtë vit dhe nuk ka pamje të tilla që të konfirmojnë vitin 2002 si vit në të cilin kanë filluar punimet. Këtë fakt e konfirmon edhe vetë subjekti në përgjigjet e dhëna Komisionit përgjatë hetimit administrativ. Ndërkohë që, sikundër edhe subjekti ka dhënë shpjegime, hedhja e themeleve është paraprirë nga një sërë procesesh përgatitore dhe deklarimi i bashkinvestitorëve nuk përjashton përlllogaritjen prej tyre të kohës për kryerjen e punimeve përgatitore në periudhën e deklaruar për fillimin e punimeve. Referuar aktit të kolaudimit, evidentohet se kolaudatori për periudhën e fillimit të punimeve, shprehet “sipas dokumentacionit të paraqitur”, duke potencuar se periudha e referuar nga ana e tij për fillimin e punimeve në këtë akt, nuk vjen si deklarim i investitorëve, por është përfutur nga të dhënat dokumentare lidhur me fillimin e punimeve të ndërtimit.

18.3. Për sa është vërtetuar, pranuar edhe nga subjekti, se punimet e ndërtimit kanë filluar në janar 2003, deklarimi nga ana e subjektit në vitin 2005, i shumës prej 2.420.000 lekësh, të investuar për ndërtim, dëshmon për vlerën jo të pakonsiderueshme të detyrimeve të pashlyera të akumuluar përgjatë viteve 2003-2004. Pretendimi i subjektit se gjatë vitit 2003 dhe gjatë vitit 2004, nuk është kryer ndonjë pagesë prej tij dhe, për këtë arsye, ai nuk ka kryer deklarime, nuk kishte si të deklaronte një shpenzim që nuk e kishte realizuar, dhe se detyrimi lind për shkak të një kontrate a fature që nuk ka ekzistuar në këtë rast, bie ndesh me konceptin ligjor të deklarimit dhe kontrollit të pasurive në mënyrë periodike nga subjektet deklaruese, të formalizuar edhe në përmbajtjen e formularit të deklarimit, si edhe në funksion të procesit të rivlerësimit ku deklaratat periodike shërbejnë si provë për kontrollin e saktësisë dhe ligjshmërisë së burimeve për krijimin e pasurive⁵². Në kuptim të nenit 4, shkronja “dh” e ligjit 9094/2003⁵³, edhe sikur të konsideroheshin të mirëqena shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte në DIPP përpara vitit 2005, vlerën e detyrimit financiar ndaj bashkinvestitorit K. B. , për sa kohë, në përmbushje të barrës së provës, ka deklaruar: *me marrëveshje verbale mes bashkëpronarëve, pasi përfundonte një pjesë e punimeve, kryeshin përlllogaritjet dhe secili paguante pjesën e vet takuese tek z. K. B. .* Kontrolli i deklarates së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklarimet e mëparshme, i shërben Komisionit dhe Kolegjit⁵⁴ për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij. Mosdeklarimi i kohës së fillimit të punimeve në deklaratën *vetting*, si dhe

⁵¹ Deklarata noteriale e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe tre bashkinvestitorët, si dhe akti i kolaudimit.

⁵² Në faqen 5 të formularit, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, udhëzohet: “në tabelën e mëposhtme duhet të renditen të gjitha detyrimet financiare (kredi, hua, borxh etj.) që keni pasur ose keni dhe që ju kanë shërbyer për të krijuar pasuri të paluajtshme apo të luajtshme”.

⁵³ Ligji 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4, shkronja “dh”, përcakton se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj”.

⁵⁴ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 6/2018 (JR), paragrafi nr. 14; nr. 7/2018 (JR), paragrafët nr. 73, 74; nr. 8/2018 (JR), paragrafi nr. 43; nr. 9/2018 (JR), paragrafi nr.42; nr. 10/2018 (JR), paragrafi nr. 67; nr. 12/2018 (JR), paragrafi nr. 24.11; nr. 9/2019 (JR), paragrafi nr.10.1.1; nr. 19/2019 (JR), paragrafi nr. 22.4, nr. 12/2021 (JR), paragrafi nr. 24.4.

shpjegimet kontradiktore në pyetësorë për kohën e fillimit të punimeve, kohë e cila hedh dritë për përcaktimin e momentit të krijimit të pasurisë, si një element i rëndësishëm për verifikimin e burimeve të krijimit të saj, passjell që deklarimi i subjektit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë të bjerë ndesh me përcaktimet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për ta bërë apartamentin të banueshëm, investimi prej tij ka vijuar për punimet pasuese deri në vitin 2008, dhe ndërtimi i godinës 4 kate +1 kat nuk ka përfunduar në vitin 2006, pasi për efekt të legalizimit, objekti konsiderohet i përfunduar edhe kur ka mbaruar vetëm karabinaja, trupi gjykues analizon si vijon.

19.1. Referuar praktikës së legalizimit të ndërtesës⁵⁵, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe tre bashkinvestitorët kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit për legalizim të ndërtesës më datë 17.05.2005. Ky formular është plotësuar sipas formatit të miratuar me ligjin nr. 9304, datë 28.10.2004, “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”⁵⁶. Sipas shënimit të theksuar në fund të këtij formulari: *ky formular shoqërohet me fotografi të katër pamjeve të objektit*, në këtë praktikë, gjenden katër foto që paraqesin godinën në fazë ndërtimi, konstruksion i përfunduar pesë kate, ndërtuar muret dhe pjesë të fasadës ballore të objektit [disa nga ballkonet] janë të suvatuara.

19.2. Referuar dokumentit “Deklaratë noteriale”⁵⁷, akt që gjithashtu i është bashkangjitur praktikës së legalizimit, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe tre bashkinvestitorët, deklarohet prej tyre se ndërtimi ka nisur në muajin maj 2002 dhe ka përfunduar në muajin prill 2006. Ky dokument është i nënshkruar edhe nga arkitekti dhe konstruktori⁵⁸. Referuar aktit të kolaudimit “tekniko-ekonomik” të objektit “godinë banimi 4 kate + 1 kat dyqan”⁵⁹, bashkëlidhur po ashtu praktikës së legalizimit, përcaktohet: *bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se punimet kanë filluar në muajin maj 2002 dhe, për përfundimin e punimeve, përcaktohet: objekti ka përfunduar në muajin prill 2006.*

19.3. Lidhur me pretendimet e subjektit se periudha e deklaruar në dokumentet e praktikës së legalizimit është për efekt të këtij procesi dhe, sipas parashikimeve të nenit 3 të ligjit 9482/2006, objekti quhet i përfunduar edhe kur ka përfunduar vetëm karabinaja, trupi gjykues konstaton se: (i) formulari i vetëdeklarimit të objektit informal, për efekt legalizimi, mban datën 17.3.2005, pamjet e katër fotove të paraqitura në përmbushje të kërkesave të ligjit 9304/2004, pasqyrojnë

⁵⁵ Shkresa e ASHK/Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me nr. {***}, datë 19.12.2019, me të cilën është përcjellë në Komision kopje e dosjes së plotë të praktikës së legalizimit të objektit ndërtesë 5 kate, Zona Kadastrale {***}, nr. Pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, rruga “{***}” Tiranë.

⁵⁶ Ligji 9304, datë 28.10.2004, “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 4403, datë 23.11.2004, botuar në fletoren zyrtare nr. 90, datë 9.12.2004, parashikonte:

- Neni 2, pika 1: “Ky ligj zbatohet për efekt legalizimi dhe urbanizimi në ndërtimet pa leje brenda territorit të zonës informale, të përfunduara në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji [...]”
- Neni 7, shkronja “a”: “Për ndërtimet pa leje, shtetasit detyrohen: a) që për një periudhë 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të bëjnë pranë njësisë së urbanistikës të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse vetëdeklarimin e ndërtimit pa leje që kanë përfunduar dhe të sipërfaqes së zënë, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij ligji”.
- Neni 12: “Mosdeklarimi brenda afatit kohor, deklarimi i rremë i ndërtimit dhe i sipërfaqes së zënë, si dhe mosparaqitja e dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor sjell përjashtimin nga trajtimi dhe mospajisjen me dokumentin e legalizimit të shtetasve që kanë ndërtuar pa leje në zonat informale”.

⁵⁷ Nr. {***} rep., datë 10.12.2009, notere M. Sh. (vërtetuar nënshkrimi i deklaruesve në prani të noteres).

⁵⁸ Arkitekt A. M., nr. licence {***}; konstruktor E. P. nr. licence {***}.

⁵⁹ Kolaudator Ing. B. H., licence {***}, paraqitur kopje e licencës e noteruar me nr. {***} rep., datë 5.02.2010.

përfundimin e karabinasë, mureve dhe pjesërisht suvatimin e fasadës ballore; **(ii)** subjekti dhe bashkinvestitorët nuk kanë pasur arsye të deklarojnë jo saktësisht të dhënat për fillimin dhe përfundimin e punimeve në deklaratën e datës 10.12.2009; **(iii)** akti i kolaudimit, i firmosur edhe nga katër bashkinvestitorët, megjithëse nuk ka datë, është përpiluar pas përfundimit të objektit dhe investimit për ta bërë atë funksional për banim. Inxhinieri që ka hartuar këtë akt, ka depozituar edhe kopjen e licencës të noteruar më datë 05.02.2010, që dëshmon se akti i kolaudimit është depozituar pas kësaj date. Krahas referencës ligjore të përdorur nga Komisioni, për të arsyetuar se kolaudimi i punimeve është kryer vetëm pas përfundimit të gjithë punimeve të nevojshme në ndërtesë dhe jo për efekt legalizimi⁶⁰, në analizë të përmbajtjes së aktit të kolaudimit, pika 15 e tij, “cilësia e punimeve”, rezulton se edhe nga *kontrolli viziv*, jepet përshkrimi për cilësinë e materialeve të përdorura në funksion të përdorimit të ndërtesës për banim, fakt i cili gjithashtu provon për sa ka konkluduar Komisioni. Pretendimi i subjektit se data e fillimit dhe përfundimit të punimeve të përcaktuara në këtë akt është bazuar në një deklaratë të bashkinvestitorëve, në kushtet e mungesës së dokumentacionit për shkak të ndërtimit informal, vjen në kundërshtim me vetë përmbajtjen e aktit, ku nga kolaudatori referohet se: *bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rezulton se punimet e objektit kanë filluar në muajin maj 2002*. Gjithashtu, referimi në dokumentacion citohet edhe për përshkrimin e cilësisë së punimeve të rifiniturës dhe karabinasë. Pohimi i subjektit se *akti i kolaudimit nuk merr kuptim për efekt të ligjit të legalizimit*, përforcon idenë e pasqyrimin të të dhënave të sakta, për sa, sipas vetë pohimit të subjektit, ky dokument nuk do të ishte i nevojshëm për t’u përdorur për efekt të përfitimit nga ligji për legalizimet, por vetëm sa i përket qëndrueshmërisë së objektit.

19.4. Lidhur me pretendimin e subjektit se *përfundimi i objektit në vitin 2008, provohet me faktet e pasqyruara në DIPP periodike, deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe akti i ekspertimit tekniko-inxhinierik, që janë në unitet me njëra-tjetrën dhe Kolegji duhet të vlerësojë vërtetësinë e deklaratimeve dhe të rrëzojë konkluzionin jologjik të KPK-së*, analizohet se: (i) referuar përmbajtjes së aktit të ekspertimit teknik, me objekt: “Përcaktimi i kohës së ndërtimit të poseduar (tashmë në pronësi) nga kërkuesi”, rezulton se nuk përcaktohet koha e përfundimit të punimeve sipas një ekspertize apo vlerësimi teknik, por jepen të dhëna që rezultojnë në kontradiktë edhe me shpjegimet e subjektit në pyetësorë⁶¹. Subjekti, për të marrë përgjigje për kohën e përfundimit të ndërtimit përmes ekspertizës teknike, ka drejtuar kërkesën: “[...] bazuar në imazhet satelitore në sitet *online* si “google earth” apo “ortophoto”, e realizuara prej Qeverisë Shqiptare, të përcaktohet koha e realizimit të ndërtimit të objektit në bashkëpronësi të z. Astrit Shema etj.”. Duke marrë në konsideratë sa analizohet në aktekspertimin teknik, se imazhet satelitore të përfutuara nga fotografimi ajror, janë plane grafike që nuk japin të dhëna për punimet në tërësi për ta bërë objektin të banueshëm/funksional, nga formulimi i kërkesës prej subjektit, mjetet e referuara prej tij për t’u përdorur nga eksperti, ai ka kufizuar mundësinë për një ekspertizë teknike në funksion të përcaktimit të kohës kur kanë përfunduar punimet e ndërtimit, përfshirë punimet për

⁶⁰ Udhëzimi nr. 3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 5 e tij, ku përcaktohet se përveç kolaudimit në fund të punimeve, është i detyrueshëm kolaudimi edhe gjatë procesit të punimeve, vetëm në rastet kur: “1. punimet janë komplekse dhe me vështirësi të veçanta; 2. në rastin e besimit të punimeve me koncesion, raste të cilat nuk gjejnë aplikim në rastin e ndërtimit të këtij ndërtimi informal, që vërteton edhe një herë se kolaudimi i punimeve është kryer vetëm pas përfundimit të gjithë punimeve të nevojshme në ndërtesë dhe jo për efekt legalizimi”.

⁶¹ Subjekti, në pyetësorin 2, ka deklaruar: “në vitin 2007 janë bërë instalimet elektrike dhe hidraulike dhe suvatimet e jashtme të objektit”, ndërsa sipas aktekspertimit, nga pamjet grafike të imazheve satelitore në vitin 2007, identifikohet “pasqyrim i soletës apo shtresës ndërkate”.

funksionalitetin për banim të apartamentit të tij në këtë objekt. Në kontekst të deklarimeve të subjektit se: [...] nuk disponon dokumentacion në lidhje me etapat dhe zërat e punimeve të kryera [...] mbajtja e dokumentacionit nuk ka qenë e detyrueshme dhe e kërkuar me ndonjë akt ligjor apo nënligjor të mëparshëm që të mundësonin vënien në dispozicion të dokumentacionit justifikues për llogari të këtij deklarimi [...], realizimi i aktekspertimit teknik me mjete me të cilat nuk mund të përcaktohet koha e përfundimit të ndërtimit, dështon vetë qëllimin e përmbushjes së barrës së provës dhe, për rrjedhojë, të vetë pretendimeve të subjektit. Në DIPP 2007 dhe 2008, subjekti deklaroi investime në banesën në bashkëpronësi, por edhe duke konsideruar peshën e këtyre deklarimeve nën përgjegjësinë e ligjit 9046/2003, përdorimi i kredisë mund të ketë shërbyer për kryerjen e punimeve shtesë që rrisin vlerën e banesës, por me provat e administruara dhe të analizuara më lart, deklaratat e subjektit dhe të bashkinvestitorëve në praktikën e legalizimit, fotot e objektit të vitit 2005, është provuar se përfundimi i ndërtimit të objektit ka ndodhur në vitin 2006.

19.5. Lidhur me pretendimin se për efekte të legalizimit, objekti konsiderohet i përfunduar edhe kur ka mbaruar vetëm karabinaja, prandaj edhe nuk duhet të konsiderohet se ai ka qenë i përfunduar në kohën e vetëdeklarimit, trupi gjykues analizon si më poshtë.

19.5.1. Nga aktet, rezulton se subjekti në vitin 2005 ka deklaruar regjistrimin e familjes së tij në Gjendjen Civile të Njësisë Bashkiake nr. {***}, rruga "{***}", lagjja pranë vilave gjermane, Tiranë⁶². Referuar ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002, "Për gjendjen civile", përcaktohet se transferimi i të dhënave të gjendjes civile bëhet me kërkesë të kryefamiljarit, kur ai vërteton ndryshimin e vendbanimit për një afat jo më pak se një vit, si dhe detyrimin e tij të bëjë transferimin e gjendjes civile të familjes jo më vonë se 45 ditë nga ardhja në vendbanimin e ri⁶³. Ndryshimi i regjistrimit të gjendjes civile të subjektit dhe familjes së tij provohet edhe me certifikatën familjare të datës 09.05.2005, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Nr. {***} Tiranë, në bazë të regjistrimit të rrugës {***}, {***}⁶⁴. Referuar VKM-së nr. 184, datë 20.03.2003, kryefamiljari, në përmbushje të kërkesave të ligjit 8950/2002, kërkesën për regjistrim në vendbanimin e ri, duhet ta shoqëronte me dokumentin e pronësisë së banesës ose një kontratë qiramarrjeje, të paktën njëvjeçare⁶⁵. VKM-

⁶² Subjekti në DIPP e vitit 2005, si adresë të plotë ku është regjistruar në gjendjen civile, deklaroi: "u regjistrua familjarisht në vitin 2005, në Njësinë Bashkiake nr. {***}, rruga "{***}", lagjja pranë Vilave Gjermane, Tiranë", dhe në rubrikën "Adresa e plotë ku banoni", deklaroi: "banoj pranë lagjes "{***}" Përmet"; në DIPP-në e vitit 2006, si adresë të plotë ku është regjistruar në gjendjen civile, deklaroi: "regjistruar në vitin 2005, në lagjen në afërsi të vilave gjermane, rruga "{***}", dhe në rubrikën "Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni", deklaroi: "lagjja "{***}" Përmet"; në DIPP-në e vitit 2007, si adresë të plotë ku është regjistruar në gjendjen civile, deklaroi: "Njësia Bashkiake nr. {***}, rruga "{***}", lagjen "{***}", Tiranë", dhe në rubrikën: "Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni", deklaroi: "Me vendqëndrim aktual lagjja "{***}", Përmet"; në DIPP-në e vitit 2008, si adresë të plotë ku është regjistruar në gjendjen civile, deklaroi: "Njësia Bashkiake nr. {***}, rruga "{***}", lagjen "{***}", Tiranë", dhe nuk ka deklarim në rubrikën "Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni".

⁶³ Neni 12 i ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002: "1. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile në një zyrë tjetër të gjendjes civile, bëhet me kërkesën e kryefamiljarit, kur ai vërteton ndryshimin e vendbanimit për një afat jo më pak se një vit [...] 5. Çdo kryefamiljar është i detyruar të bëjë transferimin e gjendjes civile të familjes jo më vonë se 45 ditë nga ardhja në vendbanimin e ri".

⁶⁴ Neni 19 i ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002: "Gjendja civile e shtetasve vërtetohet dhe dokumentohet në dokumentet bazë të gjendjes civile, të hartuara nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga punonjësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë të ardhura nga të tretët sipas ligjit".

⁶⁵ VKM nr. 184, datë 20.03.2003, "Për rregullat dhe veprimet e zyrave të gjendjes civile dhe për detyrimin e shtetasve për transferimin e të dhënave të gjendjes civile", pika 1, shkronjat "a" dhe "b": "Transferimi i të dhënave të gjendjes civile, në një zyrë tjetër të gjendjes civile, bëhet me kërkesën e kryefamiljarit. Për këtë, kryefamiljari duhet të paraqesë pranë zyrës së gjendjes civile të vendbanimit të ri këto dokumente:

ja përcakton se deri në datën 28.11.2003, në mungesë të një dokumenti pronësie ose qiramarrjeje të banesës, shtetasi paraqet vërtetimin nga kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes ose kryetari i bashkisë, në qytetet pa lagje, ku ai shprehet se shtetasi banon në fshatin ose qytetin përkatës. Për sa kohë subjekti, veprimet për transferimin e gjendjes civile, i ka kryer në vitin 2005, vërtetimi i administratorit të lagjes përjashtohet si alternativë e mundshme për të mbështetur kërkesën e tij. Për sa nuk ka deklarime të subjektit apo prova të paraqitura prej tij se kryerja e transferimit të gjendjes civile është bazuar në një kontratë qiraje, të paktën njëvjeçare, opsioni i vetëm për të mbështetur kërkesën për transferim të gjendjes civile të familjes së tij, jo më vonë se 45 ditë nga ardhja në vendbanimin e ri, mbetet godina e vetëdeklaruar për legalizim më datë 17.05.2005, ngritur mbi truallin, pronë e tij në bashkëpronësi.

19.5.2. Në vështrim të parë, transferimi i familjes së subjektit në vitin 2005 në vendbanimin e ri, duket të bjerë në kontradiktë me dokumentacionin e administruar në dosjet e Komisionit, i cili referon të dhëna se deri në vitin 2007, subjekti dhe familjarët e tij kanë vijuar angazhimet e tyre në qytetin e Përmetit⁶⁶, por, duke konsideruar funksionin që ushtronte subjekti gjatë kësaj periudhe si kryetar i Gjykatës së Rrethit Përmet, po ashtu edhe faktin se punësimi i bashkëshortes së subjektit në Tiranë⁶⁷, nuk mund të ndodhte menjëherë si rezultat i transferimit të gjendjes civile, deduktohet se pasja e mundësisë për të qëndruar në banesën e re ka siguruar transferimin e gjendjes civile, por jo domosdoshmërisht është shoqëruar me ndryshimin e vendbanimit pikërisht në këtë kohë. Në kontekst të qëllimit për të cilin kryhet kjo analizë, Kolegji vëren se përdorimi i arsyeshëm i kësaj banese si vendbanim për të mundësuar transferimin e gjendjes civile, tregon se banesa kishte përfunduar në një nivel të tillë që mund të përdorej për qëllime banimi që në vitin 2005, duke kundërshtuar në këtë mënyrë pretendimin e subjektit se ajo ka përfunduar në vitin 2008.

20. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se *ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën e investimeve të kryera në godinë, nuk ka deklaruar saktë fakte të rëndësishme për këto prona të tij, ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 3.784.113 lekë për të investuar në pjesën e tij takuese, duke pretenduar se: (i) investimi për ndërtimin e godinës është kryer në vitet 2005-2008, dhe jo në vitet 2003-2006; (ii) në deklaratën e rivlerësimit “vetting”, deklarimi është i saktë, në përputhje me deklaramet në vite, përfshirja e vlerës së truallit në vlerën e ndërtesës është theksuar në deklaratë duke përdorur lidhësen “dhe”, është një mënyrë e qartë deklarimi, sipas qasjes dhe vlerësimit të tij se trualli dhe ndërtesa janë trupëzuar në një pasuri të vetme; (iii) vlera e investimit nuk është llogaritur saktë nga Komisioni, pasi nuk është përllogaritur saktë kostoja e punimeve në pjesën takuese të katit të parë (karabina) dhe kostot e ndërtimit të kryer në mënyrë informale; (iv) subjekti ka deklaruar saktë pjesën takuese dhe investimin përkatës në godinën në bashkëpronësi pasi shtetasit K. B. dhe F. B. nuk kanë deklaruar se kanë dhuruar pjesën takuese në katin përdhe, por kanë deklaruar se në pjesët takuese nuk është*

a) Kërkesën me shkrim për regjistrim në vendbanimin e ri.

b) Dokumentin e pronësisë së banesës ose një kontratë qiramarrjeje, të paktën njëvjeçare. Deri në datën 28.11.2003, në mungesë të një dokumenti pronësie ose qiramarrjeje të banesës, shtetasi paraqet vërtetimin nga kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes ose kryetari i bashkisë, në qytetet pa lagje, ku ai shprehet se shtetasi banon në fshatin ose qytetin përkatës. Ky vërtetim lëshohet mbi bazën e njohjes së gjendjes ose verifikimit në vend të vendbanimit të shtetasit, jo më vonë se 10 ditë nga kërkesa e bërë nga shtetasi për këtë veprim”.

⁶⁶ Shkolla “{***}” Përmet, vërtetim nr. {***} prot., datë 6.02.2020, për largimin e nxënësës F. Sh. në vitin mësimor 2008-2009; gjimnazi “{***}”, Përmet, vërtetim nr. {***} prot., datë 6.02.2020, për largimin e nxënësit A. Sh. në vitin mësimor 2008-2009.

⁶⁷ Sipas vërtetimit të Degës së Doganës Tre Urat Përmet, nr. {***} prot., datë 17.10.2016, bashkëshortja e subjektit ka punuar pranë kësaj dege deri në datën 21.05.2008.

investuar prej tyre, por prej subjektit; (v) qëllimi i marrjes së kredisë 30.000 euro në Alpha Bank, në vitin 2006, dhe shpenzimi i saj, ka qenë mbulimi i shpenzimeve të ndërtimit.

20.1. Lidhur me këto pretendime të subjektit, nga analizimi i akteve të fashikullit, rezultojnë faktet e mëposhtme. Në deklaratën *vetting*, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- *Truall në bashkëpronësi (Astrit Shema, K. B. , F. B. dhe Sh. M.), në Tiranë, rr. “{***}”, lagjja “{***}”, Tiranë, me sip. 500 m², mbi të cilin është ndërtuar banesa në bashkëpronësi. **Burimi i krijimit:** Kontratë shitblerje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.03.2002, Dhoma e Noterisë Tiranë. Pasuria me nr. {***}, ZK {***}, dokumenti hipotekor pranë ZVRPP Tiranë nr. {***}. Vlera totale e truallit 3.900.000 lekë. Vlera e pjesës së subjektit: 975.000 lekë. Pjesa ideale e truallit në bashkëpronësi: 25%.*

- *Banesë në bashkëpronësi (Astrit Shema, K. B. , F. B. dhe Sh. M.), në Tiranë, rr. “{***}”, lagjja “{***}”, Tiranë, leje legalizimi nr. {***}, datë 02.09.2013 [...]. **Burimi i krijimit të pasurisë banesë dhe truall,** Tiranë, janë: pagat, shpërblimet ndër vite të punës sime dhe të bashkëshortes; kontratë huaje në masën 10.000 mijë euro me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.10.2005, nga shtetasi A. O.; kredia bankare e marrë prej meje dhe bashkëshortes sime pranë Alpha Bank [...]. Vlera e shpenzuar për ndërtimin e banesës informale, pjesës takuese të ndërtimit informal, në shumën prej 60.000 eurosh.*

20.2. Referuar këtyre deklarimeve, rezulton se shuma prej 60.000 eurosh është deklaruar qartë prej subjektit si vlerë e shpenzuar për ndërtimin e pjesës takuese të banesës informale. Nën përshkrimin e pasurisë së trupëzuar *banesë dhe truall*, ku përdorimi i lidhëses *dhe* kupton përfshirjen e të dy pasurive, subjekti ka bërë bashkë në deklaram burimet financiare që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive, që në rastin e pasurisë truall, nuk i ka deklaruar specifikisht. Trupi gjykues vlerëson se deklarimi në deklaratën *vetting* është i qartë për sa u përket vlerave të këtyre pasurive, duke i lexuar ato në njëjtën mënyrë si edhe Komisioni. Vlerat e pasurive truall dhe banesë janë deklaruar të ndara, pa lënë hapësira për të pretenduar që në rastin e banesës, vlera e deklaruar përfshin edhe vlerën e truallit, që në këtë rast do të ishte e rideklaruar. Përkundrejt qartësisë së deklarimit, pretendimi i subjektit krijon bindjen që subjekti e ngre këtë pretendim me synim ndikimin në zbehjen e vlerave negative të analizës financiare. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

20.3. Duke pranuar si të drejtë konkluzionin e arritur prej Komisionit se ndërtimi informal është kryer në periudhën 2003-2006, në Kolegj u krye analiza financiare për të verifikuar burimet e ligjshme për financimin e kësaj pasurie. Kjo analizë mbajti në konsideratë: (i) koston e ndërtimit të objektit në vlerën 7.830.965 lekë, e përlllogaritur sipas çmimeve të publikuara nga EKB-ja⁶⁸ për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës ; (ii) shpenzimet për vitet 2005 dhe 2006, sipas vlerave të deklaruara nga subjekti në DIPP përkatëse, respektivisht 2.420.000 lekë dhe 700.000 lekë; (iii) shpenzimet për vitet 2003-2004, si diferencën e mbetur nga totali i koston, zbritur shpenzimet e viteve 2005 e 2006. Analiza në Kolegj u krye në dy opsione, duke reflektuar në një version garantist edhe pretendimin e subjektit për gjendjen karabina të katit përdhe, gjendje e cila pasqyrohet edhe në fotot e objektit të administruara përgjatë hetimit administrativ. Kolegji e kreu këtë analizë duke aplikuar për përcaktimin e vlerës së koston së kësaj faze, vlerën prej 40% të vlerës së koston së objektit sipas çmimeve të EKB-së. Në opsionin e parë, duke përlllogaritur shpenzimet totale të ndërtimit me koston e publikuara, nga ku rezultoi se subjekti ka

⁶⁸ Udhëzimet e KM: nr. 1, datë 08.05.2003; nr. 1, datë 04.03.2004; nr. 5, datë 23.11.2005; nr. 5, datë 07.09.2006.

pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e investimit në ndërtim, si dhe për përballimin e shpenzimeve familjare në shumën 3.624.113 lekë; dhe në opsionin e dytë, duke përlllogaritur shpenzimet e ndërtimit të katit përdhe në fazën karabina në masën 40%⁶⁹, përkundrejt 50% të përlllogaritur në analizën financiare të paraqitur prej subjektit në Komision, nga ku rezultoi se subjekti ka pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e investimit në ndërtim, si dhe për përballimin e shpenzimeve familjare në shumën 2.375.121 lekë. Bazuar në këto rezultate të analizës financiare, trupi gjykues konstatoi se në secilin version, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlera të larta, të cilat e vendosin atë në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20.4. Në konkluzion të analizimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me pasurinë ndërtesë 4 kate + 1 kat, në bashkëpronësi me shtetasit K. B. , F. B. dhe Sh. M. , të ndodhur në qytetin e Tiranës dhe të ndërtuar mbi pasurinë truall si më sipër, Kolegji çmon se subjekti:

(i) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke mos deklaruar kohën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kërkojnë përcaktimin e qartë të kohës së krijimit të pasurive në pronësi që deklarohen në deklaratën e pasurisë *vetting*, situatë faktike e cila bie ndesh me parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;

(ii) nga analiza financiare e kryer në Kolegj, edhe në versionin më garantist, sipas të cilit do të pranoheshin pretendimet e tij lidhur me fazën e ndërtimit të katit përdhe me kosto më të ulët për shkak të gjendjes karabina, subjekti rezultoi se gjendet në kushtet e mungesës të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar vlerën e investimit në ndërtimin e pjesës takuese të pasurisë në bashkëpronësi, në shumën 2.375.121 lekë, në periudhën kohore 2003-2006, situatë faktike e cila kualifikohet sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 21.** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pambështetur në ligj dhe në provat e administruara konkluzionin e Komisionit se ai *nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes Benz 210”, {***}, në momentin e blerjes, dhe rezultoi se evidentohet ekzistenca e deklarimit të rremë nga subjekti, referuar germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke pretenduar se: (i) vlera e shitjes së mjetit në vitin 2017, nuk është e dhënë apo fakt mbi të cilin mund të ngrihen dyshime për vlerën reale të blerjes së mjetit në vitin 2010; (ii) diferenca për të plotësuar çmimin e plotë të blerjes, është dhënë përkohësisht nga i afërmi i subjektit K. B. , vlerë e cila është shlyer plotësisht gjatë vitit 2010, dhe për këtë fakt, kjo vlerë nuk është deklaruar në DIPP 2010; (iii) mosdeklarimi i huas në momentin e blerjes (*në fund të vitit kur huaja u shlye, burim i blerjes së automjetit ishin të ardhurat e subjektit*), mund ta bëjë deklarimin të paplotë, por jo të rremë; (iv) Komisioni, në rastin e subjektit, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm me qëndrimin e mbajtur në vendime për raste të ngjashme të subjekteve të tjera⁷⁰.*

⁶⁹ Referuar praktikës në Kolegj, shih vendimet nr. 35, datë 23.11.2021; nr. 22, datë 16.09.2020.

⁷⁰ Subjekti referon vendimin e KPK-së nr. 46, datë 24.07.2018, duke cituar pjesë të tij: “Nëse pasaktësia ose mospërputhja është e palidhur me fshehjen e pasurisë dhe është pasojë e një konteksti të caktuar të perceptimit të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit, atëherë kjo rrethanë nuk mundet kurrsesi të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore [...]”. Si dhe vendimin e KPK-së nr. 161, datë 18.06.2009, nga i cili citon: “[...] Komisioni konkludon se jemi përpara një pasaktësie në deklarim të personit të lidhur dhe për rrjedhojë dhe të subjektit të rivlerësimit, por që nuk e cenon ligjshmërinë e burimit të të ardhurave”.

21.1. Nga dokumentacioni i administruar në fashikujt e Komisionit, rezulton se për pasurinë/automjet, tip “Mercedes Benz 210”, {***}, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit as në deklaratën *vetting*, dhe as në DIPP 2010, ku e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në vlerën 800.000 lekë⁷¹. Në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet e realizuara së bashku me bashkëshorten. Në përgjigje të barrës së provës, për mungesë të burimeve financiare për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se në datën e blerjes së automjetit, nuk ka disponuar likuiditete të mjaftueshme dhe diferenca për të plotësuar çmimin e plotë të blerjes i është dhënë përkohësisht nga z. K. B. . Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, nuk është pasqyruar ky fakt, për shkak se shumën e dhënë nga z. K. B. , e ka shlyer gjatë vitit 2010, Sipas dokumentacionit të përcjellë nga DSHPTRR, ky mjet është shitur në datën 18.11.2017⁷².

21.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se *vlera e shitjes së mjetit në vitin 2017, prej 3500 eurosh, nuk është e dhënë apo fakt mbi të cilin mund të ngrihen dyshime për vlerën reale të blerjes së mjetit në vitin 2010*, rezulton se subjekti nuk është ngarkuar me përgjegjësi nga ana e Komisionit për vlerat e deklaruara prej tij për blerjen dhe shitjen e këtij mjeti. Në të kundërt, Komisioni – për gjetjen lidhur me diferencën mes çmimit më të lartë të blerjes së automjetit në Gjermani nga shtetasi D. S. në vitin 2009, me çmimin më të ulët të e shitjes së mjetit nga ky shtetas te subjekti, pas pesë muajsh, në vitin 2010 – ka vlerësuar bindës argumentin e subjektit, në përmbushje të barrës së provës, se diferenca vetëm 13% është fenomen i zakonshëm në tregun shqiptar.

21.3. Lidhur me çmimin e shitjes së këtij automjeti në vitin 2017, në vlerën 476.740 lekë, pas shtatë vitesh, për sa kohë vullneti i palëve është formalizuar në kontratën noteriale të shitblerjes, trupi gjykues vlerëson se analiza për vlerën reale të çmimit të shitjes, kërkon marrjen në konsideratë edhe të elementeve të tjera, përfshirë edhe ata teknikë, referenca *a-priori* vetëm në vitin e prodhimit të mjetit, apo vlerën e blerjes së tij nuk do të rezultonte e mjaftueshme për të konkluduar lidhur me çmimin e shitjes. Gjithashtu, automjeti është shitur nga subjekti dhe bashkëshortja e tij më datë 18.11.2017⁷³, kohë e cila nuk përfshihet në periudhën për të cilën subjekti ka kryer deklarinimin në përmbushje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore dhe për të cilën i është nënshtruar procesit të rivlerësimit. Ky fakt, në vlerësimin e Kolegjit, nuk prodhon të dhëna që duhet të konsiderohen për të verifikuar deklarinimet e subjektit në deklaratën *vetting* dhe as për të kontrolluar burimin e krijimit të kësaj pasurie, për pasojë trajtimi i kësaj çështjeje në kuadër të këtij procesi, konsiderohet pa relevancë.

21.4. Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie/automjet në deklaratën *vetting*, si edhe në DIPP 2010, kur e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në vlerën 800.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë pagat dhe shpërblimet e realizuara së bashku me bashkëshorten dhe, në vijim, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, për mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 290.000 lekë, për blerjen e kësaj pasurie, ka shpjeguar se në datën e blerjes së automjetit, nuk ka disponuar likuiditete të mjaftueshme dhe diferenca për të plotësuar çmimin e plotë të automjetit është dhënë përkohësisht

⁷¹ Dorëzuar në ILDKPKI më datë 27.01.2017.

⁷² Kontrata {***} rep./ {***} kol., datë 18.11.2017, notere G. B., Dhoma e Noterisë Durrës.

⁷³ Kontrata {***} rep./ {***} kol., datë 18.11.2017, notere G. B., Dhoma e Noterisë Durrës.

nga z. K. B. , vlerë të cilën e ka shlyer gjatë vitit 2010. Sipas pretendimit të subjektit, ky fakt nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, për shkak se në fund të vitit shuma ishte shlyer, dhe për të provuar lidhur me këtë pretendim, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të z. K. B. ⁷⁴. Përtej qëndrimit për vlerën provuese të kësaj deklarate, Kolegji konstaton se Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi për mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2010, duke mos i njohur pretendimin për përdorimin e huas së përkohshme prej shtetasit K. B. , por ka konkluduar në lidhje me këtë pasuri vetëm për deklarim të rremë lidhur me burimet e krijimit të saj. Në këto kushte, Kolegji vlerëson të kontrollojë këtë konkluzion të Komisionit pa e zgjeruar më tej objektin e kontrollit dhe të konkludojë ndryshe nga Komisioni lidhur me këtë çështje.

21.5. Trupi gjykues çmon se mungesa e deklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, e bën deklarimin e subjektit të rivlerësimit në këtë deklaratë të paplotë e të pasaktë dhe vjen në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Kjo situatë nuk vlerësohet prej Kolegjit se duhet kualifikuar si deklarim i rremë në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit, duke qenë se në deklaratën *vetting* mungon krejtësisht deklarimi rreth këtij fakti, për pasojë nuk mund të realizohet një proces krahasues deklarimesh me aktet e tjera, për të konkluduar për pavërtetësinë e deklarimit në deklaratën *vetting*, sipas parashikimit të mësipërm. Në konkluzion të analizës së shkaqeve të ankimit që lidhen me pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz 210” {***} , me targa {***}, blerë në vitin 2010, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratën periodike të vitit të krijimit të saj, burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet e nenit D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, situatë e cila vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

21.6. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *vlera e fitimit të realizuar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 210”, me targa {***}, në datë 27.04.2014, në shumën 72.545 lekë, vlerësohet si e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, dhe kjo vlerë iu zbrit të ardhurës së arkëtuar nga shitja e këtyre automjeteve, duke u pasqyruar në rezultatin financiar të vitit përkatës, duke pretenduar se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk parashikon si të ardhura të tatueshme fitimin e realizuar nga individët në rastin e shitjes së automjeteve, qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegji dhe, në këtë kuadër, Komisioni nuk mund ta kategorizojë këtë të ardhur si të tatueshme. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë peshën e kësaj shume në vlerësimin e pasurisë dhe problematikave të çështjes, vlerësoi pa ndikim në vendimmarrje konsiderimin ose jo si të ardhur të ligjshme të shumës prej 72.545 mijë lekësh në cilindro version që ajo do të kualifikohej dhe, për këtë arsye, e gjeti të panevojshëm trajtimin më tej të këtij shkak ankimi.*

- 22.** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pambështetur në ligj konkluzionin e Komisionit *për deklarimin e shtetasit A. O., si person tjetër të lidhur sa i përket dhënies në përdorim, pa kundërshpërblim, të apartamentit në qytetin e Vlorës, ku subjekti qëndron gjatë ditëve të punës, duke pretenduar se:* (i) nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, nuk mund të

⁷⁴ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.02.2020, lëshuar nga shtetasi K. B. përpara noterit L. D.. Përmes këtij akti, shtetasi K. B. deklaroi huadhënien për subjektin të shumës prej 350.000 lekësh, në datë 11.01.2010, dhe kthimin e saj po në vitin 2010.

aludohet për asnjë gjurmë për fshehje të mundshme të pasurisë së tij në emër të këtij shtetasi; (ii) nuk mund të ketë rrethana të tjera në kuptim të ligjit, përtej dhurimit, huas apo marrëdhënieve të biznesit që të kualifikojnë personin tjetër të lidhur. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues analizon si vijon.

22.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e rivlerësimit *vetting*⁷⁵, ka deklaruar se disponon vendqëndrim tjetër, në ditët e veçanta të punës që qëndron në Vlorë, duke referuar adresën përkatëse⁷⁶, si dhe ka depozituar deklaratën noteriale të shtetasit A. O.⁷⁷, i cili, në mënyrë të përmbledhur, deklaron se: (i) është pronari i ligjshëm i apartamentit të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, në tetor 2010, i pahipotekuar; (ii) jeton, punon dhe banon në Greqi, që nga viti 1991, dhe se apartamentin e ka blerë me kursimet e veta dhe të familjes; (iii) apartamentin ia ka lënë në përdorim baxhanakut, z. Astrit Shema, për ta përdorur sipas dëshirës, për ditët e javës që qëndron për punë, pa asnjë lloj kufizimi dhe pa pagesë, që nga momenti që është emëruar gjyqtar në Vlorë, në nëntor të vitit 2011.

Në deklaratat e interesave privatë të viteve gjatë të cilave subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Vlorë⁷⁸, subjekti i rivlerësimit, për vitet e periudhës 2011-2015, ka deklaruar se gjatë ditëve të punës qëndron në Vlorë, pa referuar adresën e saktë të vendqëndrimit, ndërsa në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, ka deklaruar vendqëndrimin tjetër, në të njëjtën adresë sikundër në deklaratën *vetting*.

22.2. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit⁷⁹ lidhur me interpretimin e përkufizimit të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që një person të konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, duhet të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: (i) një interes pasuror⁸⁰; ose (ii) çdo marrëdhënie biznesi⁸¹. Për kualifikimin e marrëdhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. O., nga dokumentet e administruara në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson se:

⁷⁵ Në formularin “Të dhëna personale të subjektit dhe personit të lidhur”.

⁷⁶ Adresa e vendqëndrimit tjetër: banesë e z. A. O., lagja “{***}”, rruga “{***}”, kati {***}, {***} (banesë e ndërtuar nga shoqëria “{***}”).

⁷⁷ Deklaratë noteriale nr. {***}, datë 20.1.2017, noter L. D., Dhoma e Noterisë Tiranë.

⁷⁸ Në DIPP të viteve 2011, 2012, 2014, 2015, në rubrikën “Nëse dispononi vendqëndrim tjetër dhe adresa e plotë ku banoni”, subjekti i rivlerësimit deklaron: “gjatë ditëve të punës qëndroj në Vlorë”, pa përcaktuar adresë të saktë; në DIPP 2013, nuk deklaron lidhur me vendqëndrim tjetër.

⁷⁹ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 21, datë 10.09.2020.

⁸⁰ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon për lidhjen e interesit që rrjedh nga një interes pasuror, duke përcaktuar cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror. Konkretisht, kjo dispozitë përcakton: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

⁸¹ Neni 3, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, përkufizimin e marrëdhënies së biznesit: ““Marrëdhënie biznesi” është çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që, në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme ose jo, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

22.2.1. Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një marrëdhënie përdorimi për pasurinë apartament të ndodhur në qytetin e Vlorës, gjatë kohës së qëndrimit në këtë qytet për nevoja të ushtrimit të funksioneve të gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kjo marrëdhënie është bërë prezente nëpërmjet deklarimit të adresës së këtij apartamenti si një vendqëndrim alternativ në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2011-2015, pavarësisht se në to nuk është identifikuar adresa e saktë e pasurisë, por vetëm fakti i pasjes së një vendqëndrimi tjetër në qytetin ku ushtron detyrën. Në këto rrethana, konstatohet se subjekti ka deklaruar këtë marrëdhënie duke lejuar organet e rivlerësimit, por edhe ILDKPKI-në, përgjatë viteve 2011-2015, të verifikojnë dhe kontrollojnë të drejtat e subjektit mbi këtë pasuri, në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore.

Referuar qëndrimeve të mbajtura prej Kolegjit për trajtimin dhe përkufizimin e kësaj marrëdhënieje përdorimi, përveçse si një marrëdhënie e verifikueshme prej organeve në çdo drejtim që ato do e vlerësojnë të nevojshme dhe arsyeshme rast pas rasti, ajo nuk është trajtuar prej kësaj jurisprudence si një marrëdhënie e cila duhet të përkufizohet sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të së cilës subjektit i lind detyrimi i provimit të burimeve të ligjshme të krijimit prej zotëruesit të saj. Në këtë kuptim, edhe referuar situatës faktike dhe gjetjeve të Komisionit, të cilat nuk referojnë apo hedhin dyshime për të drejta të tjera të subjektit, të ndryshme nga ajo e përdorimit, si edhe në mungesë të të dhënave që tregojnë për situatën e konfliktit të interesit të subjektit me shoqërinë ndërtuese të objektit ku ndodhet apartamenti⁸², Kolegji e gjen të pabazuar dhe në tejkalim të ligjit, qëndrimin e Komisionit se shtetasi A. O. duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur në raport me këtë pasuri dhe se mungesa e provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e saj do të ngarkojë me përgjegjësi subjektin sipas ligjit nr. 84/2016.

- 23.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar dhe të pambështetur në provat e administruara arsyetimin e Komisionit se *duhet të kishte deklaruar pasurinë e pritshme, truell me sip. 4.000 m² në bashkëpronësi, në {***}, Përmet, si një e drejtë reale e fituar nga dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht kohës kur e zotëron këtë pronë, duke pretenduar se nuk e ka deklaruar atë, pasi nuk ekziston më asnjë mundësi që kjo pronë të kthehet apo të kompensohet, pra nuk është më një pasuri e pritshme.*

23.1. Në deklaratën e rivlerësimit *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar pasuri truell me sip. 4.000 m² në bashkëpronësi, ndodhur në {***}, Përmet, të cilën rezulton ta këtë deklaruar në DIPP 2003, me burim krijimi: kthim në natyrë, ligji nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si trashëgimtar. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se

⁸² Komisioni ka hetuar sa i përket subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, e cila ka ndërtuar pallatin ku ndodhet apartamenti i shtetasit A. O., Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë përcjellë tri vendime gjyqësore me palë në proces shoqërinë “{***}” ShPK, të cilat nuk kanë rezultuar se janë gjykuar nga subjekti. Nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, janë përcjellë tri vendime gjyqësore me palë në proces shoqërinë “{***}” ShPK, njëri prej të cilëve rezulton të jetë dhënë në vitin 2016 nga subjekti, i cili ka vendosur rrëzimin e padisë së kësaj shoqërie. Në bazë të këtyre dokumenteve, Komisioni ka vlerësuar se nuk provohet konflikti i interesit i subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK.

nuk disponon një vendim administrativ në lidhje me njohjen, kthimin apo kompensimin e kësaj prone, me disa breza trashëgimtarë, por që askush prej trashëgimtarëve nuk u interesua apo kreu procedura ligjore për të bërë të mundur trajtimin e saj dhe se nuk ekzistonte asnjë mundësi që prona të njihej apo kompensohej dhe, për këtë shkak, nuk e ka deklaruar këtë pronë në deklaratën *vetting*.

23.2. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Kolegji vlerëson se shqyrtimi i kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimit apo kompensimit të pronës, objekt rregullimi i ligjeve që kanë trajtuar çështjen e së drejtës së pronësisë të zhveshur në mënyrë të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, janë kompetencë e organeve administrative, të cilat, bazuar në përcaktimet ligjore, vendosin për rrëzimin e kërkesës apo njohjen e së drejtës së pronësisë dhe të drejtave reale sipas ligjit. Pavarësisht se subjekti ka paraqitur kopje të dokumentacionit që, sipas tij, provon ish-pronësinë e trashëgimtarëve (gjyshit) mbi këtë pronë, nuk rezulton që pretendimi/dokumentacioni i disponuar prej tij të jetë paraqitur/shqyrtuar nga organet kompetente, të cilat të jenë shprehur lidhur me të drejtat e pronësisë së trashëgimtarëve mbi pasurinë e pretenduar. Nën dritën e interpretimit të GjEDNJ-së, sipas së cilës: *“Pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose asete, duke përfshirë kërkesat për të cilat një ankues mund të argumentojë se ka të paktën “një pritshmëri legjitime” (e cila duhet të jetë më konkrete sesa thjeshtë një shpresë), e cila do të realizohet, çka do të thotë se ai ose ajo do të gëzojë të drejtën mbi pronën.... Nga ana tjetër, shpresa për njohjen e ekzistencës së një të drejte të vjetër mbi pronën, e cila për një kohë të gjatë ka qenë e pamundur të ushtrohej në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet si “pasuri”, bazuar në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Po kështu edhe një kërkesë e kushtëzuar, e cila tejkëqet për shkak të mospërmbushjes së kushtit, mund të mos njihet si e tillë [...]. Sipas Gjykatës, një kërkesë është e kushtëzuar kur varet nga një ngjarje e pasigurt e së ardhmes⁸³, si dhe të situatës faktike, trupi gjyqës vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të kësaj pasurie, si pasuri e pritshme, përderisa subjekti nuk gëzon të drejta pronësie mbi këtë pronë në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting*, nuk është i mbështetur në ligj.*

- 24.** Subjekti, lidhur me ndërtimin informal të godinës 5-katëshe, kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se *nuk ka vepruar në përputhje me vlerat dhe parimet themelore të sjelljes së një magjistrati, jashtë funksionit të tij, gjë që e bën të cenueshëm në etikën e magjistratit*, duke pretenduar se: (i) konkluzioni ka të bëjë me kriterin e figurës, kriter për të cilin nuk ka hetuar, duke cenuar procesin e rregullt ligjor; (ii) ndërtimi informal është kryer në truallin në bashkëpronësi, jo në tokë të zaptuar, është kryer me vendimmarrje të tre bashkëpronarëve dhe jo me vendimmarrje personale; (iii) Komisioni duhej të kishte vepruar si në rastin e subjekteve të tjera të rivlerësimit, ku ka konsideruar amnistinë që i është bërë këtij fenomeni.

⁸³ *Shih vendimin e GjEDNJ-së, datë 10.11.2015, çështja Bici kundër Shqipërisë, paragrafi 49*

24.1. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit, është theksuar në një numër aktesh ndërkombëtare⁸⁴. Nën dritën e Parimeve të Bangalores⁸⁵, një kod solid i etikës gjyqësore, i cili u drejtohet drejtpërdrejt gjyqtarëve, sjellja e subjektit në shkelje të ligjit nr. 8405/1998 “Për urbanistikën”⁸⁶, cenon integritetin që një gjyqtar duhet të dëshmojë përkundrejt një vëzhguesi të arsyeshëm. Pavarësisht nga konsiderimi i sjelljes jashtëgjyqësore të subjektit jo në konformitet me standardet e shpallura në aktet ndërkombëtare, Kolegji vlerëson se *së pari*, kjo sjellje do të duhej të ishte pjesë e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale ose të bëhej pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm të të tria kriterëve, në rast se procedura e rivlerësimit për subjektin do të ishte zhvilluar në këtë kuadër, dhe *së dyti*, konsideruar rrethanat e faktit si, ndërtimin e objektit para ndryshimeve të Kodit Penal që e parashikoi këtë veprim si një shkelje që ngrihet në nivelin e një vepre penale, faktin që ndërtimi është kryer në truallin në bashkëpronësi, ndryshimet social-ekonomike të vendit dhe fenomenin e përhapur në vend që u përmyll me legjitimitimin e kësaj kategorie ndërtimesh, arrin në përfundimin se ky element nuk mund të renditet në rastin objekt shqyrtimi si një shkelje e tillë që të prodhojë një situatë që kualifikohet si një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 84/2016.

25. Subjekti i rivlerësimit kundërshton disa nga konkluzionet e Komisionit lidhur me analizën financiare për vitet 2003-2016, për të cilat trupi gjykues analizon si më poshtë.

25.1. Lidhur me pretendimin për ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}”, Përmet, në vitin 2014, në vlerën prej 108.000 lekë:

25.1.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të krijuara nga dhënia me qira e këtij apartamenti në vlerën 108.000 lekë për vitin 2014 (10% pagesa e tatim taksës), dhe në vlerën 122.400 lekë për vitin 2015; totali neto 230.400 lekë, dhe ka paraqitur dhe dokumentacion ligjor justifikues për to⁸⁷. Në kontratat e qirasë, është parashikuar se qiramarrësi

⁸⁴ “Parimet themelore të pavarësisë së sistemit të drejtësisë” i OKB-së, 1985, “Parimet e Bangalores për sjelljen në sistemin gjyqësor”, 2002, “Udhëzuesi evropian për etikën dhe sjelljen e prokurorëve” i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, 2005 etj

⁸⁵ Kodi i Bangalores për Sjellje Gjyqësore, 2001, i miratuar nga Grupi Gjyqësor për Forcimin e Integritetit Gjyqësor, i rishikuar në Tryezën e Rrumbullakët të Kryetarëve të Gjyqtarëve, organizuar në Pallatin e Paqes, Hagë, 25-26 nëntor 2002.

⁸⁶ Ligji nr. 8405/1998, “Për urbanistikën” në nenin 45 parashikon: “Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj, që do të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset me leje ndërtimi. Ky është dokumentacioni i vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi”.

⁸⁷ Kontratë qiraje, datë 3.01.2014, me palë qiradhënëse, znj. M. Sh., për apartament banimi në lagjen “{***}”, Përmet, për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014, në shumën 120.000 lekë; kontratë qiraje, datë 1.1.2015, me palë qiradhënëse, znj. M. Sh., për apartament banimi në lagjen “{***}”, Përmet, për periudhën 1.01.2015 – 30.12.2015, në shumën 144.000 lekë; depozitim për të tretë nga “Raiffeisen Bank”, datë 15.1.2016, për shumën 122.400 lekë, pagesë qiraje viti 2015, nga z. A. S. në llogarinë e znj. M. Sh.; depozitim për të tretë nga “Raiffeisen Bank”, për kalimin nga z. A. S. në përfitim të znj. M. Sh., të shumës 122.400 lekë, me përshkrimin “pagesë qiraje për vitin 2015, z. A. S., me NIPT {***}”; mandatpagesë, datë 14.1.2016, e Credins Bank, për pagesën e shumës 7.400 lekë si tatim të mbajtur në burim; shtatë mandatpagesa + një urdhërpagesë në Tirana Bank, për pagesat e tatimit në burim të qirasë, në shumën totale 14.400 lekë.

A. S.⁸⁸ do të paguajë 10% të shumës totale vjetore për llogari të shlyerjes së tatimeve. Subjekti i rivlerësimit në DIPP 2014 dhe në DIPP 2015 ka deklaruar shifrën e të ardhurave nga qiraja, duke evidentuar vlerën e tatimit mbi të ardhurat, të cilën nuk e ka përfshirë në shumën e deklaruar si të përfituar prej kësaj marrëdhënieje. Referuar ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar⁸⁹, është parashikuar detyrimi e mbajtjes në burim nga qiramarrësi (kur është person fizik/juridik) të tatimit për të ardhurat që realizohen nga marrëdhënia e qirasë. Në plotësim të këtij parashikimi ligjor, kuadri nënligjor për tatimet mbi të ardhurat, ka përcaktuar se në rastin kur qiraja paguhet nga një person i cili nuk mund të bëjë mbajtjen pagimit e tatimit në burim, detyrimi për pagimin e tatimit i ngarkohet qiradhënësit⁹⁰. Në vlerësim të rrethanave faktike, duke konstatuar se pagimi i tatimit për të ardhurat nga qiraja në vitin 2014, ka qenë detyrim ligjor dhe kontraktual i qiramarrësit, se subjekti në deklarimin në DIPP për vitin korrent e ka përjashtuar detyrimin tatimor nga e ardhura bruto e qirasë të përcaktuar në kontratë, trupi gjykues arrin në përfundimin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit, kjo e ardhur nuk i është njohur subjektit, meqenëse qiramarrësi nuk ka shlyer detyrimin e tij kundrejt organeve tatimore, është një konkluzion i pambështetur në fakte e në ligj. Mospagimi i detyrimeve tatimore të cilat, sipas ligjit dhe rrethanave faktike të përcaktuara në kontratën noteriale, i takojnë një personi të tretë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuptim të këtij procesi, për pasojë Kolegji përfshiu në analizën financiare të këtij viti edhe këtë të ardhur të deklaruar prej tij, rrethanë e cila nuk zhbëri gjithsesi balancën negative të këtij viti kalendarik.

25.2. Lidhur me pretendimet për saktësime të shpenzimeve të jetesës [*automjete (karburant, mirëmbajtje, taksa), për subjektin dhe bashkëshorten në periudhën 2007-2016, si dhe shpenzime për pushime brenda vendit*], analiza financiare e kryer në Kolegj saktësoi vlerat përkatëse në rastet kur u konstatua se pretendimi i subjektit ishte i bazuar, saktësime që nuk ndryshuan balancën e kësaj periudhe, edhe për ato vite që rezultojnë me balancë negative.

25.3. Lidhur me pretendimin se *shpenzimet e interesit në vlerën 103.961 lekë, për kredinë në Alpha Bank, janë paguar nëpërmjet transfertës bankare (principal dhe interesa) nga P. dhe Sh. G. në vitin 2009*, nga aktet në fashikuj, rezulton se bashkëshortja e subjektit më datë 12.01.2009, ka depozituar në llogarinë e kredisë në Alpha Bank, shumën 1.200 euro. Në po të njëjtën datë, nga kjo llogari janë mbajtur nga banka interesat e kredisë. Data e pagesës së interesave rezulton 14 ditë përpara datës së likuidimit total të kësaj kredie nga P. dhe Sh. G.. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

25.4. Lidhur me pretendimin se *nga shitja e automjetit “autoveturë, tip Renault Clio” në vitin 2012, humbja është në vlerën 50.000 lekë*, konstatohet se në kontratën e shitblerjes së këtij

⁸⁸ Referuar të dhënave nga QKB/ Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, A. S. figuron i regjistruar si “person fizik”, NIUS {***}, datë regjistrimi 6.11.2006, dhe me status “çregjistruar” në datë 12.01.2016. Nga “Vërtetimi i kryerjes së aplikimit”, vërtetohet se në datë 24.11.2015, A. S. ka kryer aplikimin për “çregjistrim personi fizik”.

⁸⁹ Referuar në ligjin 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, në ndryshimet e këtij ligji me ligjin 8841/2001, në nenin 33/1 dhe 34/4, u shtuan përcaktimet: “Një person i cili i paguan një individ rezident të ardhura nga kontratat e qirasë, mban tatimin për këto të ardhura në masën 10%. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen”.

⁹⁰ Referuar udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, sipas pikës 2.6.4, për të ardhura të paguara nga persona, të cilët nuk mund të bëjnë mbajtjen e tatimit në burim për llogari të organeve tatimore shqiptare, individit përfitues i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor përkatës tatimin në masën 15% të të ardhurave të realizuara, jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

automjeti⁹¹, janë pasqyruar dy vlera për çmimin e shitjes, përkatësisht 450.000 lekë dhe 290.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP të vitit 2012, ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit tip “Renault Clio”, në vlerën 290.000 lekë. Trupi gjykues vlerëson se çmimi i shitjes së automjetit është ai i deklaruar nga subjekti në deklaratën vjetore të interesave, deklarim i bërë prej tij nën përgjegjësinë e ligjit 9046/2003, për rrjedhojë humbja nga shitja e automjetit, është në vlerën 210.000 lekë, dhe pretendimi i subjektit është i pabazuar.

25.5. Lidhur me pretendimin se vlera e pajisjes për sistem ngrohje/ftohje është përlllogaritur në analizën financiare të vitit 2015 edhe si zë më vete, edhe në zërin “Shpenzime për arredim”, rezulton se Komisioni e ka marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit të ngritur prej tij në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ, dhe në analizën financiare përfundimtare ka përlllogaritur si shpenzim vetëm vlerën e blerjes së pajisjes. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të tejkaluar këtë pretendim të subjektit.

25.6. Në konkluzion të vlerësimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me treguesit financiarë si më sipër arsyetuar, nga analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën 2007-2016, në këndvështrim edhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të ngritura në ankim, sërish ai gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve të kryera gjatë kësaj periudhe, në vlerën prej 2.696.048 lekësh, situatë faktike e cila kualifikohet sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

25.7. Duke pasur në konsideratë përfundimet e arritura si më lart për secilin prej shkaqeve të ankimit të ngritura prej subjektit, ndonëse disa nga shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit u gjetën të drejta nga trupi gjykues, konkluzionet e arritura lidhur me to, nuk arritën të cenojnë drejtësinë e vendimmarrjes së Komisionit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Në këtë kontekst, Kolegji analizoi edhe pretendimin e subjektit për cenim të së drejtës së parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së, për arsye se shkaqet e shkarkimit nuk bazohen në ligj dhe provat e administruara, dhe masa e dhënë ndaj tij nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke vlerësuar se në procesin e rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit nga organet e rivlerësimit, i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë, bazuar në standarde objektive dhe duke siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe në proporcion me shkeljet e konstatuara. Subjekti i rivlerësimit Astrit Shema ka dështuar të jetë i besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë si më lart arsyetuar, pasi rezulton se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vite dhe ka bërë deklarime të pasakta në deklaratën e pasurisë *vetting*, në një nivel i cili nuk lejon Kolegjin të aplikojë parimin e proporcionalitetit në favor të subjektit të rivlerësimit. Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konkludon se vendosja e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra është në proporcion me shkeljet e konstatuara në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe i mbështetur në rrethanat e faktit që kanë rezultuar gjatë hetimit.

26. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Astrit Shema ka bërë deklarim të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë nën dritën e parashikimeve të nenit D, pikat 1, 2 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 239, datë

⁹¹ Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.02.2012, notere A. O..

21.02.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të tij, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 239, datë 21.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Shema.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 28.06.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi